



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 665, datë 02.11.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES OLKEDA LIÇE, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Olkeda Liçe, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares Olkeda Liçe, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njej ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren Olkeda LICE.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari është emëruar gjyqtare në Janar të vitit 2014, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, (aktualisht vijon detyrën në këtë gjykatë). Ajo ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit në tre dokumenta të sjella nga vetë subjekti i rivlerësimit, por edhe në vendimet që iu përkasin tre dosjeve¹. Konstatohen aftësi të mira në identifikimin e ligjit të zbatueshëm në vendimet që iu përkasin dy dosjeve gjyqësore.² Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, që paraqitet për gjykim. Gjyqtarja Olkeda Manellari ka gjykuar çështje penale themeli, por edhe çështje civile me palë kundërshtarë. Në gjykimet penale është konstatuar se gjyqtarja njeh dhe zbaton mjaft mirë legjislacionin penal dhe procedural penal. Ajo kualifikon saktë veprën penale atribuar të pandehurit dhe analizon drejt elementët përbërës të figurës së krimit. Në lëndën e së drejtës civile është konstatuar se gjyqtarja përgjithësisht zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi. Ndërkohë një vendim civil është ndryshuar plotësisht nga apeli, i cili ka konstatuar se gjyqtarja kishte zbatuar gabim dispozitat e ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Në katër rastet e vëzhguara dhe që iu përkasin çështjeve civile, është konstatuar se gjyqtarja analizon bazën ligjore të padisë, por përfshin në analizë edhe dispozita të tjera ligjore në kuadër të zgjidhjes së drejtë të çështjes. Dispozita ligjore citohet dhe analizohet në raport me faktet e pretenduara nga palët. Në një gjykim civil gjyqtarja sqaron kuptimin juridik të “shkresës së thjeshtë apo shkresës private” dhe argumenton se kur ajo ka fuqi provuese për palën që e paraqet atë si provë.*

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Gjyqtarja në vendimet penale, referuar natyrës së gjykimit (gjykim penal themeli ose kërkesë) i kushton rëndësi përcaktimit të detajuar të fakteve të çështjes dhe përshkrimit të tyre në një ose disa pjesë të arsyetimit të vendimit, në varësi të volumit të rrethanave të faktit apo natyrës së gjykimit sipas kërkesës objekt shqyrtimi.

Në vendimet e themelit gjyqtarja, nxjerr faktet e provuara nga tërësia e provave të administruara në gjykim duke përshkruar fillimisht kronologjinë e ngjarjes gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal, si dhe veprimet e kryera nga i pandehuri, duke i integruar provat mbi të cilat mbështeten faktet. Elementë të faktit penal bëhen pjesë e analizës së elementëve të figurës së veprës penale

¹ Çështja penale nr. 71106-01410-62-2015 (810) regjistri themeltar; çështja penale nr. 52201-02230-622015(1097) regjistri themeltar; çështja civile nr.11211-00473-62-2014(780) regjistri themeltar.

² Çështja civile nr.21286-01659-62-2014(1457) regjistri themeltar; Çështja penale nr. 61005-01382-62-2014(927) regjisri themeltar.

në pjesën e titulluar “*Vlerësimi i gjykatës*”, duke i kushtuar një rëndësi specifike paraqitjes dhe listimit të fakteve thelbësore mbi të cilat mbështetet analiza e provave dhe kualifikimi ligjor. Në gjashtë vendimet penale të analizuara, nëpërmjet të cilave është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi i të pandehurit, gjyqtarja evidenton dhe analizon faktet të cilat ndikojnë në individualizimin e dënimit.

Në çështjen me objekt “*Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë*”,³ faktet e çështjes janë evidentuar në mënyrë përshkuese në nënndarjen e parë me titull “*Faktet e çështjes*”. Në këtë pjesë renditen në mënyrë kronologjike veprimet hetimore të kryera nga prokuroria dhe policia gjyqësore në funksion të provueshmërisë së faktit penal të pretenduar, si dhe shkaqet objekt shqyrtimi.

Në çështjen penale me objekt akuzat “Vjedhja”, “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, “Kundërshtimi i punonjësve të policisë së rendit publik” dhe “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” pa dëshmi aftësie, faktet e çështjes janë të integruara si vazhdimësi e procedurës dhe nuk referohen si pjesë më vete. Ato paraqiten në mënyrë kronologjike bashkë me veprimet hetimore dhe procedurale të kryera nga organi i prokurorisë dhe policisë gjyqësore. Gjyqtarja paraqet të gjitha faktet e referuara dhe veprimet procedurale të kryera me qëllim provueshmërinë e tyre. Pavarësisht se faktet e çështjes nuk referohen në nëndarje të posaçme ato identifikohen lehtë dhe janë të pasqyruara në mënyrë të plotë dhe të qartë.

Në çështjen penale me objekt akuze “Dhuna në familje” faktet e çështjes nuk referohen si nëndarje më vete por janë pjesë integrale e vendimit gjyqësor. Ato paraqiten në mënyrë të detajuar duke u integruar edhe me provat e marra me qëllim provueshmërinë e tyre.

Në çështjen penale me objekt akuze “Vrasje nga pakujdesia” faktet e çështjes paraqiten të integruara me provat në një nëndarje të posaçme me titull “Faktet dhe provat”. Ato evidentohen të plotë në mënyrë kronologjike.

Në çështjen me objekt akuze “Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”, rrethanat e faktit paraqiten në mënyrë kronologjike dhe përshkruhen duke referuar në provat e administruara nga organi i akuzës. Nuk ka një ndarje më vete të tyre, por evidentohen lehtë si vijimësi logjike në pjesën përshkuese dhe arsyetuese të vendimit gjyqësor.

Në çështjen penale me objekt akuze “Organizim i llotarive të palejuara” dhe “Fshehje e të ardhurave”, rrethanat e faktit pasqyrohen të integruara me veprimet hetimore. Nuk ka një nëndarje të veçantë për përshkrimin e tyre.

Gjyqtarja në vendimet civile i kushton rëndësi përshkrimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes, në përputhje më provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në tetë vendimet gjyqësore me natyrë civile, parashtrihen në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, të integruara me to rezultojnë edhe provat e marra gjatë shqyrtimit të çështjes.

³Vendim nr.887, datë 25.08.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në tre çështje gjyqësore civile, rrethanat e faktit pasqyrohen si nëndarje më vete e emërtuar “Rrethanat e faktit”. Aty bëhet një përshkrim i plotë dhe kronologjik i fakteve të çështjes, veprimeve procedurale dhe provave të integruara në proces.

Në dy çështje gjyqësore civile, parashtrimi i rrethanave të faktit duket si vijimësi e zhvillimit të arsytimit gjyqësor. Nuk ka një titull më vete lidhur me pasqyrimin e fakteve të çështjes, por përshkrimi i tyre është i plotë dhe kronologjik.

Në tre çështje gjyqësore civile, rrethanat e faktit ndahen si titull më vete “Lidhur me faktet e provuara gjatë procesit gjyqësor”, aty pasqyrohen të plota rrethanat që lidhen me çështjen, provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe shpjegimet e plaëve rreth fakteve që lidhen me çështjen.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në të gjitha vendimet e vëshguara, pavarësisht natyrës së gjykimit (gjykim civil, gjykim penal) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose gjykim i shkurtuar), rrethanat e faktit parashtrihen në fillim të pjesës përshkruese – arsytuese, pas parashtrimit të rrethanave procedurale që lidhen me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore si dhe vlerësimin lidhur me kërkesat procedurale të palëve. Në çështjet civile, rrethanat e faktit pasqyrohen si titull më vete, “Rrethanat e faktit” ose “Lidhur me faktet e provuara gjatë procesit gjyqësor”.

Evidentohet një përshkrim i plotë e rrethanave të faktit dhe analizë e provave të marra në gjykim në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimi juridik të tij, apo në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (civil apo penal), duke treguar kujdesin e duhur për të bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe të veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi. Ajo paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet juridike, duke integruar në përmbajtjen e tyre provat e lejuara gjatë gjykimit në shërbim të konkluzioneve të Gjyqtarës në lidhje me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes. Paraqitja e fakteve të çështjes, duke iu referuar vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja apo të përzgjedhura me short, bëhet duke iu referuar përmbajtjes së kërkesë padisë, pretendimeve dhe shpjegimeve të palëve në gjykim dhe provave shkresore të administruara në seancë gjyqësore. Gjithashtu evidentohet se faktet gjenden edhe te nëndarja e vlerësimit ligjor të gjykatës mbi kërkesëpadinë, pjesë në të cilën analizohen provat mbi të cilat mbështeten dhe provohen faktet e çështjes. Analiza e rrethanave të faktit bëhet në mënyrë të qartë, të plotë dhe mbi bazën e një rendi kronologjik.

Provat e paraqitura nga palët në disa raste parashtrihen të ndara në vendim, por në përgjithësi janë të integruara dhe të evidentueshme në mbështetje të rrethanave të faktit.

Sa më sipër, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik civil apo penal vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, gjykim penal, apo kërkesë penale*) rrethanat e fakteve parashtrihen në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të

vendimit. Evidentohet analizë e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe i integruar me provat e administruara gjatë gjyqimit. Në të gjitha vendimet gjyqësore konstatohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

- Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja përcakton natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, apo penale. Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtarja përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje bashkëpronësie, detyrimin për pagim dëmshpërblimi, marrëdhënie pune, kthim shume etj.*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale apo natyrën e kërkesës penale (*kërkesë për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit*). Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese gjyqtarja konstaton nëse çështjet civile zgjidhen me pajtim ose jo, dhe citon dispozitat procedurale që referon lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes. Në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën gjyqtarja nuk thellohet në arsyetim, por thjesht konstaton ekzistencën e juridiksionit dhe kompetencës për shqyrtimin e çështjes. Në një rast⁴ pjesë e procedurës është bërë edhe vendimi i ndërmjetëm i gjykatës për thirrjen e personit të tretë në proces. Gjithashtu, në rastin e gjyqimit të një çështje penale⁵, është cituar, por nuk është arsyetuar, kërkesa e palëve për gjykim të shkurtuar. Në katër vendime gjyqësore⁶ nuk citohet asgjë lidhur me procedurën. Në një vendim⁷ procedura është pasqyruar si titull më vete në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit dhe gjyqtarja bën një analizë të juridiksionit gjyqësor penal dhe të kompetencës nga pikëpamja lëndore dhe tokësore. Gjyqtarja gjithashtu, citon edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 18.05.2005; nr.14, datë 17.04.2007. Në këtë vendim analizohet gjithashtu instituti i gjyqimit të shkurtuar dhe citohet praktika unifikuese e vendosur me vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me

⁴ Vendimi nr.1278, datë 06.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

⁵ Vendimi nr.952, datë 17.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

⁶ Vendimi nr.583, datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Vendimi nr. 95, datë 16.02.2016 I Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Vendimi nr.621, datë 10.09.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

⁷ Vendimi nr. 962, datë 18.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile/administrative dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

(i) *Në vendimet civile (kërkim page, njohje bashkëpronësie, kthim shume për dëmin civil të ardhur si pasojë e aksidentit, shpërblim dëmi, dëmshpërblim që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, pagim detyrimi, njohje pavërtetësie dokumenti, etj)*, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, të Kodit të Punës, por edhe ligjeve organike përkatëse, nga ku evidentohet më konkretisht se:

- a) Në vendimin me objekt “Kërkim page”, gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitën kushtetuese përkatësisht nenin 49 mbi lirinë e zgjedhjes së profesionit, identifikon dhe zbaton dispozitat materiale relevante nenet 11, 12, 23, 110, dhe 116, të Kodit të Punës në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, përkufizimin e kontratës së punës, detyrimet e punëmarrësit dhe punëdhënësit. Identifikon nenin 311 të Kodit të Procedurës Civile mbi mundësinë e gjykatës për të caktuar modalitetet e ekzekutimit të detyrimit.⁸
- b) Në vendimin gjyqësor me objekt “Njohje bashkëpronësie”, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenin 199 e vijues të K. Civi në funksion të mënyrës së krijimit të bashkëpronësisë, analizës së institutit juridik të bashkëpronësisë, të bashkëpronësisë vullnetare dhe të detyrueshme si dhe të pjesëve të bashkëpronësisë. Gjyqtarja citon gjithashtu, Ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” për të shpjeguar regjimin juridik të banesave të privatizuara, Ligjin nr. 7688, datë 13 mars 1993 “Për bashkëpronësinë në banesa” që është bërë pjesë e Kodit Civil me hyrjen në fuqi të tij me 1 nëntor 1994.⁹
- c) Në vendimin gjyqësor me objekt “Kthim shume” gjyqtarja identifikon si ligjin procedural ashtu edhe atë material që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes. Në mënyrë të vecantë analizon ligjshmërinë e termave të marrëveshjes së pajtimit, nenin 158/b të KPr.C mbi mundësinë për të marrë në analizë ligjshmërinë e marrëveshjes së palëve ndërgjyqëse. Për të shqyrtuar në tërësi kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet juridike të detyrimit dhe në mënyrë specifike dispozitat mbi mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore, gjyqtarja citon dhe analizon; nenet 419, 659, 690 të Kodit Civil, që përcaktojnë detyrimin si një marrëdhënie juridike, kontratën si veprim juridik, kontratën si ligj për palët, e cila mund të priset apo ndryshohet me pëlqimin e ndërsjelltë të tyre, ose për shkaqe të parashikuara në ligj. Gjithashtu citohen nenet 480, 481 të KC që sanksionojnë përgjegjësinë e debitorit kur me dashje ose nga pakujdesia krijon rrethana që bëjnë të pamundur ekzekutimin e detyrimit dhe përcaktojnë se kur debitori është në vonesë.¹⁰
- d) Në vendimin gjyqësor me objekt “Kthim shume për dëmin civil të ardhur si pasojë e aksidentit”, përveç dispozitave të KC dhe K.Pr.Civile përkatësisht, neni 627 KC për të drejtën që ka personi që ka shpërblyer demin, të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën

⁸ Vendimi nr.1367, datë 25.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

⁹ Vendimi nr. 1348, datë 22.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

¹⁰ Vendimi nr.998, datë 09.09.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

që i takon në përpjestim me shkallën e fajësisë, si dhe neni 451 i K.Pr.Civile mbi fuqinë detyruese të vendimit gjyqësor, gjyqtarja citon dhe analizon Dekretin nr. 295, datë 15.09.1992 ndryshuar me ligjin Nr. 7641, datë 1.12.1992 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Mbajtëseve të Mjeteve Motorike për Përgjegjësinë ndaj Personave të Tretë” nenin 1, nenin 2, dhe nenin 14.¹¹

- e) Në vendimin gjyqësor me objekt “*Njohje e pavërtetësisë së dokumentit*” gjyqtarja identifikon aktet nënligjore të dala në zbatim të parashikimeve ligjore mbi saktësimin e të dhënave në regjistrin kombëtar të gjendjes civile, konkretisht Udhëzimin nr.370, datë 07.12.2012 të Ministrisë së Brendshme “*Për procedurat e pastrimit të dublimeve nga regjistrat themeltarë dhe nga regjistri kombëtar i gjendjes civile*”.¹²
- f) Në vendimet gjyqësore me objekt “*Dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës, për mosrespektim të procedurës të afatit të njoftimit*”, gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitat ligjore të Kodit të Punës (*nenin 11, 21, 37, 141, 143, 144, 153, 155, 161 të KP*) në lidhje me kohëzgjatjen e kontratës së punës dhe mënyrën e zgjidhjes së saj, procedurën e zgjidhjes, dhe shkakun, vlefshmërinë dhe pasojat e menjëhershme të zgjidhjes së kontratës së punës.¹³

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si më zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale. Konkretisht identifikohet:

- a) Nenet 12, 41, 42, 59, 368, 182/2, 102 dhe 106 të K.Pr.Civile lidhur me barrën e provës, juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, thirrjen e palëve në gjykim, disponimet lidhur me shpenzimet gjyqësore;¹⁴
- b) Nenet 36/1, 41, 42, 43, 47, 54, 102 dhe 106 të K.Pr.Civile lidhur juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, të drejtën e paditësit për zgjedhjen në mes të disa gjykatave kompetente për ngritjen e padisë, disponimet lidhur me shpenzimet gjyqësore;¹⁵
- c) Nenet 35/3, 36/1, 41, 42, lidhur me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjeve.¹⁶
- d) Nenet 35/3, 36/1, 41, 42, 32/a, 32/b, 32/c, 79, 192, 193 dhe 194 të K.Pr.Civile, lidhur me juridiksionin dhe kompetencën, të drejtën e personit që cenohet në të drejtat e tij subjektive për të ngritur padinë e themelit që ka në bazën e saj të drejtën materiale të cenuar nga gjendja e faktit pavërtetësi dokumenti, njoftimin e akteve palëve, thirrjen e personit të tretë në procesin civil, vendimin e ndërmjetëm;¹⁷
- e) Nenin 451/a, të K.Pr.Civile lidhur me detyrueshmërinë për zbatim të vendimit që ka marrë formë të prerë;¹⁸
- f) Nenet 97/2, 158/b, 311/2, 108, 158/b të K.Pr.Civile, lidhur me mundësinë e realizimit të pajtimit në çdo fazë të hetimit gjyqësor, pranimin e kërkesës së palëve për zgjidhjen me pajtim të konfliktit gjyqësor, vendosja e një afati për shlyerjen e detyrimit për shkak të gjendjes së vështirë financiare të të paditurit, disponimi lidhur me pagesën e shpenzimeve

¹¹ Vendimi nr. 496, datë 15.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹² Vendimi nr.1278, datë 06.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹³Vendimi nr.583, datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁴ Vendimi nr. 654, datë 15.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁵ Vendimi nr.583, datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁶ Vendimi nr.1289, datë 10.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁷ Vendimi nr.1278, datë 06.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁸ Vendimi nr.496, datë 15.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

gjyqësore kur çështja zgjidhet me pajtim, pranimin e kërkesës së palëve për zgjidhjen e çështjes me pajtim;¹⁹

- g) Nenin 311 të K.Pr. Civile lidhur me mundësinë e gjykatës për të caktuar një afat për ekzekutimin e detyrimit në të holla;²⁰, 158/a dhe b të K.Pr.Civile, nenet 25 dhe 134 të K.Familjes lidhur me veprimet përgatitore dhe zhvillimin e seancës së pajtimit.²¹
- h) Nenet 6, 10, 12, 14, 16, dhe 28 të K.Pr. Civile në lidhje me pranimin e padisë si të bazuar në ligj dhe në prova gjykata;²²

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Punës, dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një dispozita të Kushtetutës, konkretisht nenin 49 të Kushtetutës, mbi të drejtën e personit për të fituar mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur dhe pranuar vetë.²³

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.

- a) Konkretisht, identifikohet neni 130/a të K.Penal në lidhje me akuzën “*Dhuna në familje*”;²⁴ ndryshimet e bëra në KP me ligjin nr.23/2012 me qëllim për të siguruar një mbrojtje të posaçme brenda pjestarëve të së njëjtës familje. Gjyqtarja analizon elementët e veprës penale dhe kualifikimin juridik të saj. Gjithashtu analizon llojin dhe masën e dënimit duke mbajtur në konsideratë rrezikshmërinë e veprës, përhapjen e saj, elementët e fajësisë, intensitetin e veprimeve të kryera nga i pandehuri, gjendjen gjyqësore të tij etj.
- b) Gjyqtarja indentifikon nenin 134/2 dhe nenin 22 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Vjedhja” e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë.²⁵
- c) Në ato raste kur për cilësimin juridik të veprës penale që i atribuohet të pandehurit dhe me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë penale të tij, nevojitet referimi në ligje të tjera organike, identifikohet ligji organik përkatës. Konkretisht, në analizën e anës objektive të figurës së veprës penale të “*Drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt*”, duke qenë se kjo është një dispozitë *blankete*, gjyqtarja referon nenin 115 pika 1 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.²⁶
- d) Po ashtu, në analizën e elementëve të veprës penale “*Organizimi i llotarive të palejuara*”, parashikuar nga nenet 197 e 180/1 të K.Penal, gjyqtarja në funksion të analizës se veprimet e kryera nga i pandehuri kanë qenë në kundërshtim me ligjin, referon nenin 2 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 “*Për lojrat e fatit*”, në pikën 1 të nenit 6 të ligjit “*Për Procedurat Tatimore në RSH*”.²⁷ Gjithashtu, referohen dhe analizohen nenet 197 dhe 180 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Fshehja e të ardhurave*”.
- e) Në një rast rast referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me individualizimin e dënimit apo edhe aplikimin e alternative të dënimit (*nenet 47, 48, 49,*

¹⁹ Vendimi nr.998, datë 09.09.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²⁰ Vendimi nr.1367, datë 25.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²² Vendimi nr. 1348, datë 22.10. 2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²³ Vendimi nr. 583, datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Vendim nr. 1367 datë 25.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²⁴ Vendimi nr.583, datë 27.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²⁵ Vendimi nr. 887, datë 25.08.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²⁶ Vendimi nr.621, datë 10.09.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²⁷ Vendimi nr. 952, datë 17.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

nenet 59 të K.Penal),²⁸ si dhe në një rast tjetër referohet alternativa e dënimit me burgim për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe kryerjen e një pune në interes publik (neni 63 i K.Penal).²⁹

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtarja referon, si pjesë e integruar e arsytimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal:

- a) nenet 13/3, 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, lidhur me përcaktimin e përbërjes së trupit gjykues, juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes;
- b) nenin 354 lidhur me kërkesat paraprake, nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 128 të K.Pr.Penale lidhur me vlefshmërinë e akteve, si kusht për pranueshmërinë e kërkesës për gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm të gjykimit³⁰;
- c) nenin 393/1 dhe 485 të K.Pr.Penale, lidhur me shpenzimet gjyqësore në procesin penal;
- d) nenin 190/1, gërma “a” të K.Pr.Penale lidhur me disponimin mbi provat materiale.³¹
- e) në vendimin me objekt “Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi”,³² gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, konkretisht nenet 253, 254 dhe 258, 259 lidhur me analizimin e konceptit të arrestimit në flagrancë. Gjithashtu, në funksion të vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim gjyqtarja identifikon nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masës së sigurimit personal.
- f) nenet 151/4, 171, 191, 295 të K.Pr.Penale sa i përket papërdorshmërisë së veprimit procedural të njohjes përmes fotografive dhe paraqitjes për njohje të personit³³.

Krahas dispozitave të Kodit Penal, dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, si më poshtë:

- a) nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.³⁴

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

²⁸Vendimi nr.962, datë 18.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²⁹ Vendimi nr. 621, datë 10.09.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

³⁰ Po aty.

³¹ Pjesa urdhëruese e Vendimit nr. 952, datë 17.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

³² Vendimi nr. 887, datë 25.08.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

³³ Vendimi nr. 95, datë 16.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

³⁴ Vendimi nr. 887, datë 25.08.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit gjyqtare *Olkeda Manellari*, ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në vendimet që i përkasin tre dokumenteve të sjella nga vet subjekti i rivlerësimit, por edhe në vendimet që ju përkasin dosjeve 1, 2 dhe 3. Aftësi të mira në identifikimin e ligjit të zbatueshëm ndeshen edhe në vendimet që ju përkasin dosjeve 4 dhe 5. Gjatë periudhës objekt i rivlerësimit profesional znj. *Manellari*, ka gjykuar edhe çështje penale themeli, por edhe çështje civile me palë kundërshtarë, pra ka punuar edhe në dhomën penale edhe në dhomën civile. Në gjykimet penale, që ju përkasin dosjeve 1 e 2 dhe dokumentit nr.3, është konstatuar se gjyqtarja *Manellari* njeh dhe zbaton mjaft mirë legjislacionin penal dhe procedural penal. Kështu, në këto gjykime penale është konstatuar se znj. *Manellari*, kualifikon saktë veprën penale atribuar të pandehurit, analizon drejt elementët përbërës të figurës së krimit, vlerëson dhe analizon përmbajtjen e provave të shqyrtuara prej saj, zbaton me përpikmëri kërkesat e nenit 47 të K.Penal, lidhur me caktimin e llojit e masës së dënimit që duhet të caktohet ndaj të pandehurit për krimin e kryer. Argumentohet në vendim se përse gjyqtarja zgjodhi të caktoj ndaj të pandehurit sipas rastit këtë apo atë lloj dënimi (dënimin me burgim apo dënimin me gjobë). Njeh dhe zbaton në çështjet penale gjykimin e posaçëm (gjykimin e shkurtuar), duke zbatuar edhe konkluzionet e vendimit unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë për këtë lloj gjykimi. Në gjykimet penale hasen referenca në Jurisprudencën e GJ.Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, por edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së Në rastin e veprës penale të “Dhunës në familje”, jep dallimin e kësaj vepre penale nga kundravajtja penale e “Rrahjes”. Në gjykimet penale respekton të drejtën e të pandehurit apo personit nën hetim për të patur mbrojtës (avokat) në gjykim etj. Në gjykimet penale, vendimet e dhëna nga gjyqtarja *Manellari* ose ankimohen dhe lihen në fuqi ose nuk ankimohen nga palët (shih dokumentin 3 dhe

dosjet 1, 2 dhe 5). Në gjykimin penal që i përket dosjes nr. 5, me objekt "vleftësim arresti në flagrancë e caktim mase sigurimi", kemi konstatuar një pasaktësi, kontradiktoritet, në interpretimin dhe zbatimin e nenit 252 të K.Pr.Penale që përcakton "kushtet e flagrancies". Në vendimin e saj dhënë në atë rast, gjyqtarja megjithëse arsyeton se plotësohen kushtet e flagrancies, arsyeton se arrestimi i personit nën hetim është i paligjshëm (shih më hollësisht konkluzionet në arsyetimin e vendimit të dosjes nr.5). Në lëndën e së drejtës civile është konstatuar se gjyqtarja Manellari përgjithësisht, zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi dhe vendimi i dhënë prej saj lihet në fuqi nga gjykatat më të larta (shih dokumentet 1, se 2 dhe dosjen 4). Në dokumentin 1 vendimi u la në fuqi për sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes, por u ndryshua vetëm për një kërkim të paditësit që u vlerësua i bazuar nga gjyqtarja Manellari, por u konsiderua i pabazuar nga apeli (kërkimi lidhur me procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës). Ndërkohë, vendimi që i përket dosjes nr. 4, u ndryshua plotësisht nga apeli e cila konstatoi se gjyqtarja kishte zbatuar gabim dispozitat e ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore". Në katër rastet e vëzhguara dhe që ju përkasin çështjeve civile, është konstatuar se gjyqtare Manellari, analizon bazën ligjore të padisë, por përfshin në analizë edhe dispozita të tjera ligjore në kuadër të zgjidhjes së drejtë të çështjes. Dispozita ligjore citohet dhe analizohet në raport me faktet e pretenduara nga palët. Në gjykimet civile nuk mungojnë referencat në vendimet unifikuuese të G.J.L, kur është rasti (shih vendimin e dokumentit 1). Në një gjykim civil, gjyqtarja sqaron kuptimin juridik të "shkresës së thjeshtë apo shkresës private" dhe argumenton se kur ajo ka fuqi provuese për palën që e paraqet atë si provë (shih vendimin e dosjes nr. 3)."

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*asaj materiale - civile apo penale, si dhe procedurale penale në rastin e kërkesave penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale/procedurale³⁵ bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

(i) Në vendimet civile: Përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

³⁵Kjo në rastin e kërkesave penale.

- a) Interpreton në mënyrë literale nenin 113/b të K.Civil, lidhur me mosparashkrimin të padisë së njohjes (*e drejta për të kërkuar pavërtetësinë e një dokumenti*);³⁶
- b) Interpreton nenin 113/b të K.Civil lidhur me mosparashkrimin e padive të njohje (e drejta për të kërkuar njohjen si bashkëpronarë); interpreton nenin 199 të K.Civil, lidhur me prezumimin e barazisë së pjesëve; interpreton nga pikëpamja teologjike, historike, sistematike dispozitat e Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe nga ky interpretim, Gjyqtarja arrin në përfundimin se përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezultonte në regjistrin themeltar të shtetasve në datë 01.12.1992 do të ishte pika e referimit për zgjidhjen e problemit të strehimit për shtetasit dhe rregullimi i marrëdhënieve të pronësisë mbi to, përmes privatizimit nga personat madhorë që jetonin në këto banesa. Gjyqtarja ka interpretuar në veçanti nenin 23 të ligjit të sipërcituar, lidhur me rastet e përjashtimit nga e drejta e privatizimit.³⁷
- c) Interpreton nenet 627 të K.Civil dhe nenin 15 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” për të konkluduar se pala paditëse legjitimohet ti drejtohet gjykatës, si dhe se në rastin konkret shkak i lindjes së detyrimit lidhet me shkaktimin e dëmit ku shkaktar ka rezultuar të jetë i padituri; nenin 24 të ligjit të sipërcituar lidhur me humbjen e së drejtës për t’u mbuluar nga sigurimi.³⁸
- d) Interpreton nenet 419, 476, 480, 481, 659, 690 të K.Civil për të konkluduar se marrëveshja e pajtimit e arritur mes palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen me pajtim të konfliktit nuk bie në kundërshtim me ligjin (*ligjshmëria e termave të marrëveshjes së pajtimit*), respekton parimet mbi zbatimin e vullnetit të dyanshëm kontraktor³⁹.
- e) Interpreton nenet 11, 12, 22, 23, 110, 116 të K.Punës për të konkluduar se marrëveshja e pajtimit e arritur mes palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen me pajtim të konfliktit nuk bie në kundërshtim me ligjin (*ligjshmëria e termave të marrëveshjes së pajtimit*), respekton parimet mbi zbatimin e vullnetit të dyanshëm kontraktor⁴⁰.
- f) Interpreton nenin 627 të K.Civil dhe nenet 1, 2, 14 të Dekretit nr. 295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë“ lidhur me legjitimitimin aktiv të paditësit nëse ai përfshihet në skemën e sigurimit, në rastet e mungesës së kontratës së sigurimit, duke interpretuar se duhet të plotësohen tri kushte kumulative: pala e paditur nuk ka patur kontratë sigurimi të automjetit në momentin e ndodhjes së aksidentit; pala e paditur ka qenë shkaktar i aksidentit; paditësi ka kryer pagesën e të dëmtuarit në vend të të paditurit.
- g) Interpreton në mënyrë literale dhe teleologjike nenin 12 të K.Punës, në lidhje me elementet e nevojshëm që duhet të plotësohen në mënyrë që kontrata e punës, e lidhur midis palëve të konsiderohet një kontratë individuale pune. Gjyqtarja interpreton nenin 4 të K.Punës, lidhur me ligjin e zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënies juridike të punës objekt shqyrtimi. Gjyqtarja interpreton literalisht dhe sistematikisht nenet 141, 143, 144, 148, 153 -153, të K.Punës sa i përket të drejtës së punëmarrësit dhe punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës, respektimit të afatit të njoftimit, respektimit të procedurës së njoftimit. Gjyqtarja interpreton në mënyrë literale dispozitën materiale (*nenin 153 të K.Punës*) duke analizuar në përputhje me faktet, kushtet dhe kriteret që duhet të

³⁶ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

³⁷ Vendimi nr. 1348, datë 22.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

³⁸ Vendimi nr. 1289, datë 10.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

³⁹ Vendimi nr. 998, datë 09.09.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁰ Vendimi nr. 1367, datë 25.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

përbushen në mënyrë kumulative, që të legjitimojnë punëdhënësin që të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me punëmarrësin. Gjyqtarja, duke e konsideruar si pjesë e ligjit të zbatueshëm, ka analizuar edhe dispozitat e Kontratës Kolektive të Punës të aplikueshme, duke analizuar çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse. Pas interpretimit të ligjit të zbatueshëm, Gjyqtarja ka arritur në përfundimin se punëmarrësi nuk ka kryer shkelje me faj të rëndë të asnjë detyrimi kontraktual, apo na ato të parashikuara nga Kodi i Punës, ndaj punëdhënësit. Duke vlerësuar se nuk ka asnjë shkelje nga ana e punëdhënësit, Gjyqtarja në interpretim logjik të nenit 155/3 të K.Punës, të aplikuar në rrethanat e rastit konkret, ka vendosur caktimin e masës së dëmshpërblimit për paditësin punëmarrës për shkëputjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënieve të punës.⁴¹

Në vendimet penale: Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së fakti penal, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të Kodit Penal në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, veçanërisht në çështjet penale të themelit, ku ky interpretim është i domosdoshëm (*nenet 291, 134, 151/1, 236/2, 130/a,1, 85 të K.Penal*). Interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Kryesisht, konstatohet se gjyqtarja interpreton teorikisht normën relevante të Kodit Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale përkatëse që i atribuohet të pandehurit, dhe në vijim duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit. Dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale, duke u përqendruar më tepër në anën objektive të saj. Kjo analizë kryhet në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi, me përjashtim të Vendimit nr. 952, datë 17.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në të cilin nuk rezulton të jenë analizuar objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive për figurat e veprave penale të “Organizimi i llotarive të palejuara” dhe “Fshehje e të ardhurave” të parashikuara nga nenet 197 e 180/1 i Kodit Penal. Megjithatë, Gjyqtarja identifikon dhe interpreton ligjet e posaçme, në ato raste kur dispozita penale materiale ku të referon fakti penal është një dispozitë *blanket*, si p.sh:

-Në Vendimin nr. 952, datë 17.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke qenë një dispozitë e bardhë neni 197 i Kodit Penal, është referuar në nenet 2, 4 të Ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 « Për lojërat e fatit » i ndryshuar, për të konkluduar se i pandehuri është i paregjistruar sipas ligjit për zhvillimin e bixhozit, aktiviteti që kryen ai është aktiviteti i lojërave të fatit dhe se ushtrimi i veprimtarisë së lojërave të fatit mund të realizohet vetëm nga personat juridikë që krijohen sipas ligjit të sipërcituar. Në të njëjtin vendim, Gjyqtarja thërret për interpretim nenet 12 pika 4/c, 44 të Ligjit nr. 10033 datë 11.12.2008 « Për lojërat e fatit » si dhe Ligjin « Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë » për të analizuar anën objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, duke konkluduar se i pandehuri ka pasur përveç detyrimeve administrative, edhe detyrime tatimore, ndaj ai ka kryer evazion fiskal.

-Në Vendimin nr.130, datë 10.09.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Gjyqtarja duke pasur në konsideratë se neni 291 i K.Penal, është dispozitë blankete, është referuar në nenin 115 pika 1 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 « Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë » mbi detyrimin për t’u pajisur me leje drejtimi për automjete dhe motomjete nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

⁴¹ Vendimi nr. 583, datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, evidentohet edhe interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*) ose aplikimin apo jo të alternativave të dënimit (*neni 59 dhe 63 të K.Penal*). Në këto raste, gjyqtarja ndalet në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri nga një masë dënimi më e ulët apo edhe të një dënimi alternativ të parashikuar në nenin 63 të K.Penal.⁴² Veçanërisht, në Vendimin nr. 95, datë 16.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Gjyqtarja ka analizuar në mënyrë të detajuar sa i përket llojit dhe masës së dënimit: kriteret e rrezikshmërisë së veprës penale (objekti, vendi, koha, mënyra, pasoja, rrethanat që kanë ndikuar); kriteret e rrezikshmërisë së autorit të veprës penale (qëndrimi i autorit ndaj veprës penale dhe pasojave; gjendja sociale, arsimimi, gjendja në të cilën kryhet, gjendja gjyqësore); kriterin e shkallës së fajësisë; kriteret e rrethanave lehtësuese; kriteret e rrethanave rënduese. Në këtë vendim, Gjyqtarja referon në çështjen *Vinter dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* për të arsyetuar një nga funksionet e dënimit penal, atë të parandalimit të të pandehurit për të kryer sërish vepra penale. Ndërsa në vendimet e tjera penale burim vlerësimi, Gjyqtarja pasi citon nenet 47-50 të Kodit Penal, aplikon drejtëpërdrejtë rrethanat e rastit. Në dy vendime penale burim vlerësimi⁴³, Gjyqtarja ka aplikuar llojin e dënimit me gjobë, por nuk rezulton të ketë identifikuar dispozitën konkrete ku parashikohet ky lloj dënimi dhe as nuk rezulton të ketë interpretuar atë (*nenin 34 të Kodit Penal*) për të analizuar kriteret e ligjit që duhet të përmbushen, për ta aplikuar në rastin konkret.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

- a) Në kërkesën penale, me objekt caktim mase sigurimi, në funksion të përcaktimit nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, gjyqtarja bën interpretim teorik të dispozitës, duke dhënë kuptimin e saj, si dhe duke përcaktuar kushtet dhe kriteret ligjore për aplikimin e saj, veçanërisht sa i takon elementit të dyshimit të arsyeshëm. Interpretimi në nivel teorik i dispozitës (*neni 228 i K.Pr.Penale*) mbështetet me referimin edhe të qëndrimit të GJEDNJ në vendimin “*Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, Fox Cambell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*”.⁴⁴
- b) Në vendimin penal me objekt akuzat “Vjedhja”, “Shkatërrim i pronës me zjarr”, “Kundërshtimi i punonjësve të policisë së rendit publik”, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” pa dëshmi aftësie”, Gjyqtarja duke bërë një interpretim literal dhe sistematik të neneve 171 e vijues (njohja e personave), 128, 191, 295 të K.Pr.Penale, i ka dhënë përgjigje pretendimeve të mbrojtjes për papërdorshmërinë e veprimit procedural të njohjes së personit përmes fotografisë. Përpos kësaj analize, në mbështetje të arsytimit dhe interpretimit të saj, Gjykata ka thirrur jurisprudencën e Gjykatës së Lartë (*Vendim nr. 159 datë 15.05.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë*) ku është trajtuar veprimi procedural njohja përmes fotografisë, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (*Vendim nr. 106,*

⁴²Vendimi nr.621, datë 10.09.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴³ Vendimi nr. 962, datë 18.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Vendim nr. 952, datë 17.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁴Vendimi nr.887, datë 25.08.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

datë 02.10.2013 i Gjykatës Kushtetuese) ku është trajtuar njohja me anë të fotografisë e të pandehurit, si pjesë e ligjshmërisë së provave të marra në një proces.

- c) Në çështjet penale të themelit gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në mbështetje të argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin lidhur me kërkesën për procedim me gjykim të shkurtuar (*nenet 128, 403, 404 i K.Pr.Penale*), në mbështetje të të cilit referon edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*);

Në çështjet civile, në fushën e së drejtës së punës (marrëdhënie pune) Gjyqtarja interpreton literalisht nenet 36, 40, 43, 47 të K.Pr.Civile dhe sistematikisht nenet e sapocituara, në harmoni me parashikimin e posaçëm në nenin 7 të K.Punës, për të identifikuar gjykatën kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore. Në interpretim literal të nenit 54 të K.Pr.Civile, Gjyqtarja trajton të drejtën e zgjedhjes së paditësit, kur i paraqiten disa alternativa për gjykatën kompetente⁴⁵.

Në konfliktin me natyrë civile *në fushën e së drejtës së pronësisë*, Gjyqtarja, ndonëse nuk e citon normën procedurale konkrete, interpreton nenin 233/ç të K.Pr.Civile në faktet procedurale të çështjes, për të sqaruar në vendim lejimin e provës me dëshmitarë, për shkak të rrethanave historike, shoqërore të kohës dhe marrëdhënieve të veçanta familjare të palëve ndërgjyqëse⁴⁶.

Në mosmarrëveshjen me natyrë civile, *në fushën e përmbushjes së detyrimeve*, për të zgjidhur në themel çështjen, Gjyqtarja është investuar të marrë lloje të ndryshme të provave të parashikuara në ligjin procedural, duke interpretuar sistematikisht nenet 259 (*shkresa e thjeshtë*), nenin 182/2 (*thirrja personalisht palës ndërgjyqëse për t'u pyetur në proces*), nenin 12 (*barra e provës*) të K.Pr.Civile. Gjyqtarja ka bërë një interpretim të zgjeruar të institutit procedural të barrës së provës, duke arsyetuar dhe analizuar kuptimin e faktve krijuese, fakteve penguese dhe atyre shuese, ku ka përcaktuar sipas rastit pala që ka barrën e provës për t'i provuar⁴⁷.

Në konfliktin me natyrë civile, *për pavërtetësinë e dokumentit*, Gjyqtarja për të interpretuar nenin 32/c të K.Pr.Civile, integron në pjesën arsyetuese të vendimit jurisprudencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr. 5/2012. Po ashtu, Gjyqtarja bën një interpretim teleologjik të nenit 32/c të K.Pr.Civile dhe neneve 272 e vijues të tij, për të konkluduar mbi pavërtetësinë/falsifikimin intelektual të dokumentacionit⁴⁸.

Në mosmarrëveshjen me natyrë civile, *me objekt padi regresi*, Gjyqtarja interpreton në mënyrë literale, sistematike, të zgjeruar nenin 451/a të K.Pr.Civile (vendimin e formës së prerë) dhe institutin e gjësë së gjykuar, në kuptimet e tij formal, substancial, konstituiv, objektiv, subjektiv për të konkluduar se ka efekt dhe iu kundrejtohet vetëm palëve ndërgjyqëse në proces. Mbi këtë bazë, Gjyqtarja vendos zgjidhjen në themel të padisë, konkretisht rrëzimin e padisë, pasi nga interpretimi në tërësi i dispozitës procedurale civile rrjedh se i padituri nuk ka qenë palë në procesin në të cilin paditësi është detyruar që të paguajë shumën e dëmshpërblimit, që ja kërkon me padi regresi të paditurit.⁴⁹

Gjyqtarja, në dy prej vendimeve gjyqësore civile, ka zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim midis palëve, si një mjet efektiv për zgjidhjen e konflikteve në çdo fazë të hetimit gjyqësor. Në

⁴⁵ Vendimi nr. 583, datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Vendim nr. 1367 datë 25.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁶ Vendimi nr. 1348, datë 22.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁷ Vendimi nr. 654, datë 15.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁸ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁹ Vendimi nr. 496, datë 15.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

interpretim literal dhe sistematik të neneve 97/2 dhe 158/b të K.Pr.Civile, Gjyqtarja sqaron synimin e parashikimit ligjor mbi zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes civile, momentin se kur mund të arrihet pajtimi, roli i gjykatës në këtë proces pajtimi dhe natyra juridike e vendimit që miraton pajtimin. Gjyqtarja gjithashtu interpreton literalisht nenin 311/2 të K.Pr.Civile për mënyrën e ekzekutimit të detyrimit të rënë në ujdë nga palët në marrëveshjen e pajtimit.⁵⁰

- *Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.*

Në disa nga vendimet e analizuara rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ, në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- a) Në Vendimin nr. 887, datë 25.08.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt shqyrtimin e kërkesës dhe caktimin e masës së sigurimit personal, në dobi të analizimit të konceptit të dyshimit të arsyeshëm, Gjyqtarja inkorporon në vendim jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (çështjet *Fox, Cambell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar.*)
- b) Në Vendimin nr.962, datë 18.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Gjyqtarja, në funksion të konstatimit se është kompetente për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi, për shkak të natyrës së çështjes, e ka mbështetur analizën e saj juridike në Vendimin nr. 12 datë 18.05.2015, Nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese, mbi gjykatën e caktuar me ligj për gjykimin e çështjes penale me objekt akuze “Vrasje nga pakujdesia” parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal.
- c) Në Vendimin nr.95, datë 16.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në funksion të argumentimit të pretendimeve të mbrojtësit për papërdorshmërinë e veprimit procedural të njohjes së personit përmes fotografisë, Gjyqtarja ka integruar në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor Vendimin nr. 159 datë 15.05.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe Vendimin nr. 106, datë 02.10.2013 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilët është trajtuar dhe është mbajtur qëndrimi se njohja me anë të fotografisë është provë e përdorshme dhe e marrë në mënyrë të ligjshme.
- d) Në Vendimin nr. 583, datë 13.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt marrëdhënie pune, për të analizuar lidhur me masën e dëmshpërblimit në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të zgjidhjes së marrëdhënies së punës, (*dëmshpërblimin me karakter ndëshkues për punëdhënësin dhe ndreqës i dëmit moral të shkaktuar punëmarrësit*) gjyqtarja citon Vendimin Unifikues nr. 19, datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- e) Në vendimet penale, kur është proceduar me gjykim të shkurtuar, rezulton se nga ana e Gjyqtarës është cituar dhe zbatuar në drejtim të vlerësimit për pranimin e kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- f) Në Vendimin nr.1278, datë 06.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Gjyqtarja, në funksion të arsyetimit për interesin për të ngritur padi në rastet e padive me objekt

⁵⁰ Vendimi nr. 998, datë 09.09.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.; Vendimi nr. 1367 datë 25.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

pasaktësi dokumenti ka referuar në Vendimin Unifikues nr. 5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

-Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Nga tërësia e vendimeve të analizuara, rezultojnë se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezultojnë se gjyqtarja njih dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- a) *Parimin e ligjshmërisë (mosdënimi pa ligj) – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit në të cilat gjyqtarja analizon domosdoshmërinë e ekzistencës dhe provueshmërisë së të katër elementëve të figurës së veprës penale, si kusht për ekzistencën e saj dhe për pasojë, për përgjegjësinë penale të të pandehurit për faktin penal që i atribuohet. Në disa raste, Gjyqtarja referon në mënyrë të shprehur këtë parim.⁵¹
- b) *Parimet e përgjithshme në caktimin dhe individualizimin e dënimit, si parimi i barazisë para ligjit, parimi i drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe parimi i humanizimit*. Këto parime rezultojnë të jenë zbatuar nga gjyqtarja në të gjitha vendimet penale të themelit, ku ajo interpreton paraprakisht qëllimin e dënimit penal dhe më pas vijon me përcaktimin dhe individualizimin e dënimit, duke iu referuar kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 47 të Kodit Penal, prezencën dhe ndikimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese. Në disa raste, Gjyqtarja referon në mënyrë të shprehur tek ky parim.⁵²
- c) *Parimin e respektimit dhe garantimit të lirisë së njeriut, në caktimin e masës së sigurimit*, ku Gjyqtarja interpreton me një përkujdesje të arsyeshme kushtet e përgjithshme (dyshimi i arsyeshëm, ekzistenca e veprës penale, ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë); kushtet e veçanta (rreziku i marrjes ose vërtetësisë së provës, largimi ose rreziku i largimit të të pandehurit, rreziku se mund të kryejë krime të rënda ose më të rënda); përshtatëshmërinë dhe proporcionalitetin në masën e sigurimit të caktuar.
- d) *Parimin e zbulimit të së vërtetës objektive, të drejtës së mbrojtjes, shpejtësisë, verbalitetit dhe kontradiktoritetit*, në analizimin e përgjegjësisë disiplinore të punëmarrësit.⁵³ Gjyqtarja, ndonëse nuk e referon shprehimisht, i jep rëndësi të veçantë parimit të mbrojtjes së punëmarrësit, si pala më e dobët në marrëdhënien kontraktore të punës.
- e) *Parimin e procesit të rregullt ligjor*, aspekte të të cilit rezultojnë nga konteksti i vendimeve të analizuara, në të cilat rezultojnë se gjyqtarja i kushton rëndësi elementëve të tillë si: disponibiliteti i padisë nga ana e paditësit, mosdalja tej kërkimeve të padisë (neni 6 i K.Pr.Civile), barra e provës, kontradiktoriteti, garantimit të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, etj.

⁵¹ Vendimi nr. 621, datë 10.09.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁵² Po aty.

⁵³ Vendimi nr.583, datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, praktikën e konsoliduar të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari, ka shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor, si në vendimet që i përkasin çështjeve penale, ashtu edhe në vendimet që ju përkasin çështjeve civile.*”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton, si rregull në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit, gjithashtu.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine, të tilla si “*audita altera parte*”, “*Judicis est judicare secundum allegata et probata*”, “*onus probandi*” (barra e provës), “*res judicata est*” (mbi të njëjtin objekt gjykimi), “*causa pretendi*” (të njëjtin shkak ligjor), “*judicatum non facit jus nisi inter partes*” (Vendimi i formës së prerë parimisht prodhon efekt vetëm ndaj palëve ndëgjyqëse në atë proces), “*ratione materiae*” (kompetente në lëndë), “*Nullum crimen, nulla poena sine culpa*” (Askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për një veprim ose mosveprim, i cili nuk parashikohet shprehimisht si vepër penale në ligjin penal që është në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale), por si rregull kuptimi i tyre jepet në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin. Në rastet e rralla kur nuk është dhënë kuptimi, ka rezultuar i qartë nga përmbajtja e fjalisë, paragrafit apo kontekstit të argumentimit në vendim.

Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit, apo si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik, përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij, ose rezulton i qartë nga konteksti i arsyetimit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qënë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen gjithnjë me referencë ligjore (shih 5 dosjet e vëzhguara). Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor. Struktura e vendimit është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar.”*

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i tregon kujdes për prezantimin e fakteve, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Evidentohet ndjekja e një metodologjie të qartë në strukturimin e pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit. Konstatohet se vendimet civile përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile:

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat lidhur me gjykatën, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

Në pjesën përshkruese–arsyetuese gjejnë pasqyrim në mënyrë të strukturuar: (i) Procedura gjyqësore (*e cila përgjithësisht titullohet nga ana e gjyqtarës*), në të cilën gjyqtarja rendit çështjet e kompetencës dhe juridiksionit civil, për të vijuar më pas me parashtrimin e vendimmarrjeve të ndërmjetme me qëllim përgatitjen e çështjes për shqyrtim dhe garantimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, siç janë thirrja e personit të tretë në proces (neni 192 i K.Pr.Civile), marrja e provës kryesisht (nenet 223 dhe 224 i K.Pr.Civile), paraqitja e kërkesës për zgjidhjen e çështjes me pajtim (neni 158/b i K.Pr.Civile); (ii) rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim (*e cila titullohet në disa vendime “Rrethanat e faktit” dhe në disa vendime “Lidhur me faktet e provuara gjatë procesit*

gjqësor”); (iii) parashtrimi në mënyrë të përmbledhur i pretendimeve të palëve (në dy prej vendimeve⁵⁴ janë nënndarje më vete, ndërsa në vendimet e tjera janë të integruar në pjesën e rrethanave të çështjes dhe provat); (iv) për të vijuar më tej me analizën ligjore, ku gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionet e saj.

Pjesa e dispozitivit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, etj. Në vendimet civile të përfunduara me zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes, Gjykata në një prej rasteve ka përcaktuar afatin për përmbushjen e detyrimit konform nenit 311/2⁵⁵ të K.Pr.Civile. Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, në nenin 310 të K.Pr.Civile.

Po kështu, konstatohet se vendimet penale përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale:

Pjesa hyrëse përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohën e zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenin përkatës të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimeve është e ndarë në disa pjesë, ku pjesa e parë përgjithësisht nuk titullohet formalisht, si p.sh “Procedura”, “Rrethanat e faktit/çështjes”, ndërkohë që pjesët në vijim listohen formalisht si: “Arsyetimi juridik i gjykatës” dhe “Individualizimi i dënimit penal”. Gjyqtarja përdor struktura të ndryshme në varësi të llojit të vendimit dhe kompleksitetit të çështjes konkretisht: i) pa nënndarje në titullim, por del e qartë nga përmbajtja ecuria procedurale, rrethanat e çështjes, provat, ligji i zbatueshëm dhe vlerësimi i Gjyqtarës; ii) nënndarje “Procedura”, “Faktet e çështjes”, “Vlerësimi i Gjykatës”, “Caktimi i dënimit”.; iii) nënndarje “Faktet e çështjes”, “Vlerësimi i Gjykatës”; iii) pa nënndarje, por trajton procedurën, provat, pretendimet mbi provat, më pas titullon “Burimet e provave”, “Ligji i zbatueshëm”, “Vlerësimi i Gjykatës”.

Pavarësisht stilit të paraqitjes estetike të vendimit (titullimit të aspekteve të arsyetuara), nga përmbajtja e vendimit rezulton se Gjyqtarja në mënyrë të detajuar analizon: (i) Rrethanat procedurale, në të cilën gjyqtarja përshkruan në mënyrë kronologjike ecurinë procedurale çështjes, duke filluar me paraqitjen e çështjes në gjykatë, shqyrtimin kryesisht të përcaktimit të kompetencës lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes, si dhe disponimin e gjykatës lidhur me kërkesën paraprake të të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar apo kërkesat e tjera për pretendimet mbi provat siç janë papërdorshmëria e provave. (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes, gjyqtarja përshkruan faktin penal objekt akuze, në përputhje dhe të integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. (iii) Në përgjithësi pasqyron edhe pretendimet e palëve gjatë

⁵⁴ Vendimi nr. 1278 datë 06.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Vendimi nr. 583 datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁵⁵Në nenin 311/2 të K.Pr.Civile, para ndryshimeve me ligjet nr.114/2016, datë 03.11.2016 dhe ligjit nr. 38/2017, 30.03.2017, parashikohej se : “...Gjykata mund të caktojë një afat për ekzekutimin e detyrimit në të holla ose ta ndajë atë me këste, me kërkesën e palës së interesuar, duke pasur parasysh gjendjen pasurore të palëve dhe rrethanat e tjera të çështjes.”

gjkimit, pas parashtrimit të rrethanave të çështjes; (iv) Vlerësimi dhe analiza juridike, në të cilën gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionin e saj.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurit, akuzën përkatëse, nenin respektiv të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, disponimin e plotë për shpenzimet procedurale, si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar, në funksion të qartësisë së tij për palët dhe lexuesin, si dhe të ekzekutimit të tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i*

rivlerësimi Olkeda Manellari, ka shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor, si në vendimet që i përkasin çështjeve penale, ashtu edhe në vendimet që ju përkasin çështjeve civile. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qënë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor... ”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal.

Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qënë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, si në çështjet civile, ashtu edhe në çështjet penale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtares”

| Propozim për nivelin e vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES | |
|---|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares Olkeda LICE në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Olkeda Manellari ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5); 1 muaj e 4 ditë (shih dosjen 1); 2 muaj e 23 ditë (shih dosjen 2); 1 vit, 1 muaj e 25 ditë (shih dosjen 3) dhe 1 vit, 2 muaj e 22 ditë (shih dosjen 4). Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në tre raste, është respektuar afati ligjor ose afati standart i gjykimi (shih dosjet 1, 2, dhe 5)...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja, vendimeve të administruara me indicie nga KPK.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes, konkretisht: Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (*vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi*), parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale.⁵⁶ Referuar vendimit nr. 887, datë 25.08.2014, rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit është regjistruar në gjykatë, në datën 23.08.2014 dhe ka përfunduar në datën 25.08.2014, duke përfunduar brenda afatit ligjor prej 48 orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe se në asnjë prej tyre nuk rezulton që gjyqtarja të ketë shkelur afatin ligjor për përfundimin e saj, e shprehur në përqindje 0-10% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 0-10% përkon me nivelin e vlerësimit maksimal 15 (pesëmbëdhjetë) pikë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, duke pasur parasysh edhe shkaqet që kanë ndikuar në këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin “0-10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

⁵⁶ Neni 259 i K.Pr.Penale parashikon se “...5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë”.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).
- Relacioni i Inspektoratit të KLD të datës 15.07.2016⁵⁷.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në tre raste, është respektuar afati ligjor ose afati standart i gjykimi (shih dosjet 1, 2, dhe 5). Në dy rastet që i përkasin dosjeve 3 dhe 4, gjykime të çështjeve civile me palë kundërshtare, afati standart i gjykimit është shkelur. Shkaqet e zvarritjes së gjykimit në këto dy raste, janë pasqyruar hollësisht në analizën që iu përket dosjeve 3 dhe 4. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, në dy prej vendimeve të prezantuara është respektuar afati standart i gjykimit (shih dokumentet 1 e 3), ndërsa në dokumentin 2 që përfaqëson një gjykim civil me palë kundërshtare, afati standart i gjykimit është shkelur.”*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10⁵⁸ çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se në çështjet e vëzhguara, gjykimi në përgjithësi ka përfunduar brenda standardeve minimale kohore, ku referuar Vendimit nr.261/2 të KLD, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezulton:

Çështje penale të kategorisë krime:

⁵⁷ Në këtë relacion konkludohet: *“1. Verifikimin e ankesës së ankueses F.K në lidhje me pretendimet për zvarritjen e gjykimit të çështjes civile, gjykuar me vendimin nr. 196, datë 16.02.2016 nga gjyqtarja Olkeda Manellari e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. 2. Arkivimin e ankesës që ka të bëjë me interpretimin e ligjit, vlerësimin e provave, konfliktin e interesave në lidhje me përfaqësimin e palëve si dhe me mosshprehjen e gjykatës për të gjitha kërkimet e palës pasi janë pretendime për fakte apo rrethana që mund të zgjidhen nëpërmjet kontrollit gjyqësor mbi apelimin gjyqësor të palëve.*

⁵⁸ Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim, konkretisht Vendimi nr.887, datë 25.08.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

- Dosja 1 - (është caktuar me short në datën 19.06.2015 dhe ka përfunduar në datën 27.07.2015) Gjykimi ka zgjatur 38 ditë, ose 1 muaj e 8 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 2 - (është caktuar me short në datën 25.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 18.12.2015) Gjykimi ka zgjatur 84 ditë ose 2 muaj e 23 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 27.05.2015 dhe ka përfunduar në datën 10.09.2015) Gjykimi ka zgjatur 106 ditë, ose 3 muaj e 14 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 10 - (është caktuar me short në datën 29.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 17.12.2015) Gjykimi ka zgjatur 79 ditë, ose 2 muaj e 18 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Vendimi 3- (është regjistruar çështja në datën 26.10.2015 dhe ka përfunduar në datën 16.02.2016) Gjykimi ka zgjatur 113 ditë, ose 3 muaj e 21 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);

Çështje civile:

- **Dosja 3** - (është regjistruar në datën 20.03.2014 dhe ka përfunduar në datën 15.05.2015) Gjykimi ka zgjatur 421 ditë ose 1 vit 1 muaj e 25 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- **Dosja 4** - (është caktuar me short në datën 31.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 22.10.2015) Gjykimi ka zgjatur 448 ditë, ose 1 vit 2 muaj e 22 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- **Vendimi 1** – (është regjistruar çështja në datën 27.03.2014 dhe ka përfunduar në datën 13.05.2014) Gjykimi ka zgjatur 47 ditë ose 1 muaj e 17 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- **Vendimi 2** – (është regjistruar çështja në datën 13.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 06.11.2014) Gjykimi ka zgjatur 266 ditë ose 8 muaj e 24 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- **Dosja 6** - (është caktuar me short në datën 09.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 10.11.2014) Gjykimi ka zgjatur 154 ditë, ose 5 muaj e 1 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- **Dosja 7** - (është caktuar me short në datën 10.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 25.11.2014) Gjykimi ka zgjatur 138 ditë, ose 4 muaj e 15 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- **Dosja 8** - (është caktuar me short në datën 08.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 09.09.2014) Gjykimi ka zgjatur 63 ditë, ose 2 muaj e 1 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- **Dosja 11** - (është caktuar me short në datën 23.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 15.04.2015) Gjykimi ka zgjatur 143 ditë, ose 4 muaj e 22 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile.
- **Çështja civile**, evidentuar nga Relacioni i datës 15.07.2016 i Inspektoratit të KLD, me palë paditëse F.K, përfunduar me Vendimin nr. 196, datë 16.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykimi i kësaj çështje ka filluar në datë 15.05.2014. Për rrjedhojë, gjykimi ka zgjatur 1 vit, 9 muaj e 1 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile të përcaktuar me Vendimin 261/2 të ish KLD.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 14 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit 261/2 të ish KLD, pasi 4 (katër) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të përcaktuar për secilën kategori. Pra në total 28.6% të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar vetëm për 71.4% të çështjeve të analizuara. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 28.6% përkon me nivelin e vlerësimit 3 (tre) pikë. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në kontekst të sa më sipër arsyetohet u analizua kompleksiteti i çështjeve, i përcaktuar në Metodologji si një nga komponentët që mund të çojë në një pikëzim më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore nga e cila rezultoi se:

1. Çështja që i përket *Vendimit civil nr.654, datë 15.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier*, me objekt padie “*1.Detyrimin e P.P të më kthejë deyrimin ligjor që më ka nga thyerja e e arit prej 1,383,300 lekë. 2. Detyrimin prej 6% në vit fitim i munguar nga interesat për shumën 166,000 lekë. 3. Shpenzimet gjyqësore në vlerën 1,573,100 ti ngarkohen të paditurve*”. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 20.03.2014 dhe datë përfundimi 15.05.2015, duke përfunduar brenda një afati prej 421 (katërqind e njëzet e një) ditë ose 1 (një) vit 1 (një) muaj e 25 (njëzet e pesë) ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr.261/2 të KLD. Afati tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është rreth 7 (shtatë) muaj e 25 (njëzet e pesë) ditë. Gjykata vëren se këtu përfshihet edhe muaji Gusht 2014 (30 ditë), i cili përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve e në këtë kontekst nuk duhet të përlogaritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar vetëm rreth 6 (gjashtë) muaj e 25 (njëzet e pesë) ditë tej standardit. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore rezulton se janë kryer 18 (tetëmbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 7 (shtatë) përgatitore dhe 11 (njëmbëdhjetë) gjyqësore. 3 (tre) seanca përgatitore janë shtyrë për t’i dhënë kohë palës paditëse për plotësimin e të metave të padisë (*përcaktimi i vlerës së objektit të padisë, pagimi i tarifës gjyqësore, për depozitimin e informacionit mbi adresat zyrtare të personave të tretë*) si dhe për njoftimin e palës së paditur dhe personave të tretë (6 *persona fizik si persona të tretë dhe dy persona fizikë të paditur*). Seancat gjyqësore janë shtyrë për njoftimin e palëve (2 *seanca*); për të paraqitur paditësi prova (2 *seanca*); për thirrjen personalisht të të paditurve dhe personave të tretë, për t’u paraqitur dhe pyetur sipas nenit 182 të K.Pr.Penale, si dhe dhënien kohë për t’u përgatitur mbi pyetjet personave të thirrur për t’u pyetur (4 *seanca*); për paraqitjen e përfaqësuesit ligjor të të paditurit (2 *seanca*). Kjo ecuri procedurale dhe kjo shkallë kompleksiteti duhet të mbahet parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimin e gjyqtarës.

2. Çështja që i përket *Vendimit civil nr.1348, datë 22.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier*, me objekt padie “*Detyrimin e të paditurave të njohin paditësat Th.Z dhe A.Z bashkëpronarë në apartamentin e banimit të banesës nr. 13, pallati 13 shkalla 4, kati I-rë, banesë 2+1 dhoma me aksesoret përkatës dhe të pjesës takuese të truallit ndodhur në Roskovec Fier*”. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 31.07.2014 dhe datë përfundimi 22.10.2015, duke përfunduar brenda një afati prej 448 (katërqind e dyzet e tetë) ditë, ose 1 (një) vit 2 (dy) muaj e 22 (njëzet e dy) ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr.261/2 të KLD. Afati tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është rreth 8 (tetë) muaj e 22 (njëzet e dy) ditë. Gjykata vëren se këtu përfshihen edhe muajt Gusht 2014 dhe Gusht 2015 (60 ditë), i cili përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve e në këtë kontekst nuk duhet të përlogaritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar vetëm rreth 6 (gjashtë) muaj e 22 (njëzet e dy) ditë tej standardit. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore rezulton se janë kryer 18 (tetëmbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 8 (tetë) përgatitore dhe 10 (dhjetë) gjyqësore. 1 (një) seancë përgatitore është shtyrë për t’i dhënë kohë palës paditëse për plotësimin e të metave të padisë; 1 (një) seancë përgatitore është shtyrë për marrjen e informacionit nga Zyra e Gjendjes Civile për adresën e të paditurit; 1 (një)

seancë përgatitore është shtyrë me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të paditësit; 4 (katër) seanca përgatitore janë shtyrë për njoftimin e të paditurve (me fletëthirrje dhe me shpallje publike). Seancat gjyqësore janë shtyrë për të paraqitur paditësi dhe i padituri prova (2 seanca); për njoftimin e dëshmitarëve (1 seancë); për mosparaqitje të përfaqësuesit ligjor të paditësit (2 seanca); për depozitimimin e konkluzioneve përfundimtare (1 seancë); për shpalljen e vendimit të arsyetuar (1 seancë). Kjo ecuri procedurale dhe kjo shkallë kompleksiteti duhet të mbahet parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimin e gjyqtarës.

3. Çështja që i përket *Vendimit civil nr.1278, datë 06.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier*, me objekt padie “*Njohjen e pavërtetësisë së dokumentit.*”. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 13.02.2014 dhe datë përfundimi 06.11.2014, duke përfunduar brenda një afati prej 8 (tetë) muaj e 24 (njëzet e katër) ditë, tej afatit 6 muaj, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr.261/2 të KLD. Afati tejkallimit të çështjes nga standardi minimal kohor është rreth 2 (dy) muaj e 24 (njëzet e katër) ditë. Gjykata vëren se këtu përfshihet edhe muaji Gusht 2014 (30 ditë), i cili përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve, e në këtë kontekst nuk duhet të përlllogaritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar vetëm rreth 1 (një) muaj e 24 (njëzet e katër) ditë tej standardit. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore, nuk ka të dhëna mbi arsyen e tejkallimit të gjykimit, pasi vendimi është i përzgjedhur nga gjyqtarja. Por, nga ecuria procedurale e çështjes rezulton se gjatë kryerjes së veprimeve përgatitore, si rezultat i shpjegimeve të dhëna pala paditëse paraqiti një kërkesë bazuar në nenin 192 të K.Pr.Civile, për të thirrur si person të tretë në këtë proces Zyrën e Gjendjes Civile, kërkesë që u konsiderua e bazuar nga Gjykata në bazë të nenit 193 të K.Pr.Civile. Po ashtu, rezulton se Gjykata ka marrë prova kryesisht në bazë të neneve 223 e 224 të K.Pr.Civile pranë Zyrës së Gjendjes Civile dhe Kompanisë Safran Aleat. Kjo ecuri procedurale dhe kjo shkallë kompleksiteti duhet të mbahet parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimin e gjyqtarës.

4. Çështja civile, evidentuar nga Relacioni i datës 15.07.2016 i Inspektoratit të KLD, me palë paditëse F.K, përfunduar me Vendimin nr. 196, datë 16.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykimi i kësaj çështje ka filluar në datë 15.05.2014. Për rrjedhojë, gjykimi ka zgjatur 1 vit, 9 muaj e 1 ditë, tej afatit 6 muaj të standartit minimal kohor për gjykimet civile të përcaktuar me Vendimin 261/2 të ish KLD. Lidhur me këtë çështje në dosje nuk ka asnjë informacion mbi kompleksitetin e çështjes, arsyet e zgjatjes së afatit të gjykimit. Këto fakte duhet të mbahen parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimin e gjyqtarës.

Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar në total për 3 vite periudhë vlerësimi⁵⁹ **884 çështje**, nga të cilat 306 çështje themeli në dy vite e dy muaj (24.01.2014 – 29.02.2016), mesatarisht 144 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 200 çështje në vit. Edhe pse ky standard nuk tejkallohet, duke marrë në konsideratë se në këtë periudhë jo të plotë trivjeçare, Gjyqtarja ka qenë me leje barrë lindje dhe për një periudhë ka gjykuar çështje civile, kryesisht menjëherë pas fillimit të detyrës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe më pas ka gjykuar çështje me natyrë penale, kjo ngarkesë pune e justifikon pikëzimin maksimal të gjyqtarës.

⁵⁹ Në periudhën korrik 2012 deri në datën 23.01.2014 nuk ka patur çështje në gjykim, pasi ka qenë në pritje të emërimit përfundimtar. Gjithashtu nga data 01.03.2016 deri në datën 03.01.2017 nuk figuron në asnjë çështje gjyqësore, pasi ka qenë me leje barrë lindje.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar si më sipër cituar, që rezulton në masën 28.6%;
- (ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit;
- (iii) moskalimin e standardit sasior të zbatueshëm mesatarisht;

vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga të dhënat statistikore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 28.6% të çështjeve jashtë standardit minimal, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares. Nga ana tjetër analiza logjike e të dhënave të burimeve të vlerësimit justifikon pikëzim maksimal për këtë tregues, edhe pse nuk ka tejkallim të treguesit minimal sasior dhe kompleksiteti i çështjes e natyra e çështjeve të gjykuara gjatë periudhës së gjykimit, ka qenë përcaktues në kohëzgjatjen e gjykimeve.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).
- Relacioni i Inspektoratit të KLD të datës 15.07.2016⁶⁰.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Olkeda Manellari ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5); 1 muaj e 4 ditë (shih dosjen 1); 2 muaj e 23 ditë (shih dosjen 2); 1 vit, 1 muaj e 25 ditë (shih dosjen 3) dhe 1 vit, 2 muaj e 22 ditë (shih dosjen 4). Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në tre raste, është respektuar afati ligjor ose afati standart i gjykimi (shih dosjet 1, 2, dhe 5)...”.

⁶⁰ Në këtë relacion konkludohet: “1. Verifikimin e ankesës së ankueses F.K në lidhje me pretendimet për zvarritjen e gjykimit të çështjes civile, gjykuar me vendimin nr. 196, datë 16.02.2016 nga gjyqtarja Olkeda Manellari e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. 2. Arkivimin e ankesës që ka të bëjë me interpretimin e ligjit, vlerësimin e provave, konfliktin e interesave në lidhje me përfaqësimin e palëve si dhe me mosshprehjen e gjykatës për të gjitha kërkimet e palës pasi janë pretendime për fakte apo rrethana që mund të zgjidhen nëpërmjet kontrollit gjyqësor mbi apelimin gjyqësor të palëve.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tri) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.⁶¹

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*nga 14 çështjet e marra në analizë, nga të cilat 5 (pesë) çështje penale themeli, 9 (nëntë) çështje civile themeli*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 5 (pesë) çështjet në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë 420 ditë ose 2 muaj dhe 24 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 9 (nëntë) çështjet në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë rreth 258 ditë, ose 8 muaj e 18 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.

KONKLuzioni

Referuar analizës matematikore si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjysmën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 3 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, tejkalohe vetëm për një kategori (*civile themeli*), me 2 (dy) muaj, ku duhet të llogaritet muaji gusht gjatë të cilit gjyqtarët janë me leje të zakonshme, festat zyrtare, dhe numri i çështjeve të përzgjedhura është më i lartë se gjysma tjetër e kategorive të çështjeve (penale themeli), si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja lidhur me gjykimin e kësaj kategorie çështjesh, vlerësoj se ky tregues duhet të pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

⁶¹ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtare Olkeda Manellari, ka përfunduar së gjykuari 884 çështje. Nga ky total, 145 janë çështje civile të përgjithshme, 161 penale themeli, 181 janë penale masa sigurimi, 242 janë kërkesa penale dhe 152 çështje janë kërkesa civile. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se gjyqtare Olkeda Manellari, gjatë periudhës 23.01.2014-29.02.2016, ka punuar edhe në dhomën civile seksioni i përgjithshëm, por edhe në dhomën penale. Gjyqtarja ka shqyrtuar gjithashtu edhe kërkesa penale, masa sigurimi dhe kërkesa civile. Rezultoi se gjyqtare Manellari në periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional, ka gjithsej 2 vjet, 1 muaj e 6 ditë punë si gjyqtare, pra nuk ka tre vite të plota pune. Bazuar në kriteret e përcaktuara në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, standarti sasior për gjyqtaren Olkeda Manellari do llogaritet si një mesatare e gërmës "a" dhe e gërmës "e" të këtij aneksi. Referuar nenit 3 gërma "a" të Aneksit 1, gjyqtari i shkallës së parë i dhomës penale, si relator, duhet të gjykojë jo më pak se 100 çështje në vit krime+kundravajtje penale. Ndërkohë, rezulton se gjyqtare Olkeda Manellari, në afro një vit punë (04.03.2015- 29.02.2016), ka përfunduar së gjykuari 161 çështje penale themeli. Si rezultat, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe tejkaluar standartin sasior sa i takon çështjeve penale të gjykuara. Referuar nenit 3 gërma "e" të Aneksit 1, gjyqtari i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm, duhet të gjykojë jo më pak se 120 çështje në vit që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare. Ndërkohë, rezulton se gjyqtare Olkeda Manellari për 1 vit, 2 muaj e 12 ditë(23.01.2014-04.03.2015), ka përfunduar se gjykuari 244 çështje mosmarrëveshje civile me palë kundërshtare. Si rezultat, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar standartin sasior sa i takon çështjeve civile me palë kundërshtare të gjykuara.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja Olkeda LICE ka përfunduar 884 çështje nga të cilat 161 penale themeli, 425 kërkesa penale dhe 145 civile të përgjithshme. Por sipas dosjes së rivlerësimit, gjyqtarja ka filluar të ushtrojë detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në muajin janar 2014, ndërkohë nga data 01.03.2016 deri në datën 03.01.2017 ka qenë me lejelindje. Kështu që të dhënat statistikore si më sipër i përkasin periudhës janar 2014- shkurt 2016 (2 vjet e 1 muaj e 6 ditë). Referuar tabelave statistikore për periudhën janar 2014- shkurt 2016 rezultojnë të dhënat e mëposhtme për kategori çështjesh për çdo vit kalendarik :

- Viti 2014: gjithsej 47 çështje themeli, 76.5% më pak sesa standardi i miratuar;
- Viti 2015: gjithsej 233 çështje themeli, ose 30% më shumë se standardi i miratuar;
- Viti 2016 (2 muaj): gjithsej 26 çështje themeli, ose 18% më pak se standardi i miratuar duke llogaritur për periudhën 2 mujore.

Për aspektin sasior sipas pikës 3, germa “g” të vendimit të KLD, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me seksione, si relator gjykon brenda një viti kalendarik jo më pak

se 200 çështje, penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare, i llogaritur në periudhë 3 vjeçare jo më pak se 600 çështje themeli.

Referuar të dhënave në vërtetimin nr. 3576 Prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bashkëlidhur Formularit të vetëvlerësimit, i rregullt nga pikëpamja formale, të cilat përkojnë me statistikat e deklaruara dhe i përkasin periudhës 3 vjeçare. Në këtë vërtetim shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve kalendarike dhe konkretisht:

- Në vitin 2014, i janë caktuar 424 çështje, ka përfunduar 285 çështje;
- Në vitin 2015, i janë caktuar 599 çështje, ka përfunduar 519 çështje;
- Në vitin 2016, i janë caktuar 35 çështje, ka përfunduar 88 çështje.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, si dhe për kategoritë e çështjeve të gjykuara respektivisht brenda të njëjtit vit kalendarik, dhe po kështu nuk është përlllogaritur rendimenti sipas të dhënave statistikore nga raporti i vlerësimit të KLGJ, duke u bazuar në të dhënat statistikore të Kryetarit të Gjykatës për të gjithë periudhën 3 vjeçare 01.01.2014-31.12.2016, e cila në këtë rast nuk konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, pasi Gjyqtarja ka filluar detyrën në datë 24.01.2014 dhe në datën 01.03.2016 është larguar me leje barrëindje, rendimenti duhet të përcaktohet referuar raportit të çështjeve të përfunduara 892 çështje me çështjet e caktuara 1058 çështje gjatë periudhës së vlerësimit, në **masën 84.31%**.

Në lidhje me këtë tregues gjyqtarja Olkeda Lice paraqiti kundërshtimet duke shpjeguar në mënyrë të përmbeldhur se: *Nuk jam dakort me këtë rendiment të përlllogaritur për arsyet e mëposhtme: **Së pari**, ky rendiment nuk është llogaritur duke iu referuar standardit të miratuar (Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit “Kriteret Matëse të veprimtarisë gjyqësore”), por i është referuar ngarkesës me dosje të caktuara e cila e tejkalon disa herë normën e standadit.*

***Së dyti**, në projekt-raport më është njohur si punë efektive 2 vjet 1 muaj e 6 ditë punë për periudhën e vlerësimit, ndërsa për vitin 2014 koha ime efektive është **10 muaj e 17 ditë** kalendarike e për rrjedhim edhe rendimenti duhet të përlllogaritet mbi këtë periudhë efektive.*

***Së treti**, metodologjinë që është aplikuar në projekt raport e kam aplikuar për periudhën efektive të punës, sipas projekt-raportit(2 vjet 1 muaj e 6 ditë). Nga të dhënat statistikore rezulton se unë kam përfunduar për periudhën efektive 892 çështje gjyqësore, me një efektivitet të barabartë me $892/421,2 \times 100 = 211,7\%$. Kjo shifër tregon se unë kam punuar sa për dy gjyqtarë. **Së katërti**, rendimenti është përlllogaritur mbi bazën e çështjeve të marra dhe çështjeve të përfunduara, por ndërkohë numri i çështjeve të marra është disa herë më i madh se standardi i miratuar. Për periudhën e vlerësimit më janë caktuar 1058 çështje, ndërsa sipas standardit të miratuar duhej të më ishin caktuar 421,2 çështje. Pra, më janë caktuar $1058/421,2 \times 100 = 251\%$. Rezulton të jem ngarkuar me 2,5 herë më shumë se norma e miratuar, fakt që nuk është pasqyruar në vlerësim. Gjatë periudhës së vlerësimit (Tetor 2013-Korrik 2016), unë kam qënë gjyqtare e caktuar për të gjykuar në Seksionin Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën janar-dhjetor 2014 dhe periudhën Janar 2015-Shkurt 2016, kam qënë gjyqtare e caktuar për të gjykuar në Seksionin Penal të kësaj gjykate. Sipas pikës 3 gërma “e” të Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit “Kriteret Matëse të veprimtarisë gjyqësore”, rezulton se gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator i seksionit të përgjithshëm, duhet realizojë jo më pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare në vit. Mbajtur*

parasysh sa sipër, si dhe faktin që përgjatë periudhës së vlerësimit ka patur situata objektive që kanë ndikuar në rendimentin në punë më poshtë po analizoj disa faktorë që vlerësoj se duhet të mbahen në konsideratë në pikëzimin: **i. Për vitin 2014**

Jam emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, më datë 23.01.2014. Ndërkohë që jam përfshirë në procedurat e shortit të gjykatës, më datë 11.02.2014. **Pra koha efektive në detyrë për vitin 2014 është 10 muajt e 17 ditë.** Sipas normës standard të miratuar në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit “Kriteret Matëse të veprimtarisë gjyqësore” pika 3 gërma ‘g’ (pavarësisht faktit se gjykata ka qënë e organizuar në Seksione dhe unë për vitin 2014 kam qënë pjesë e seksionit civil të përgjithshëm dhe për këtë arsye norma standard për mua duhet të jetë pika 3 gërma ‘e’ e Aneksit1) ngarkesa minimale e punës duhej të ishte 176 çështje civile ($200/12\text{muajt} \times 10 \text{ muajt} = 166.6 \text{ çështje}$; $200/12\text{muajt}/30 \text{ ditë} \times 17 \text{ ditë} = 9,4 \text{ çështje}$, pra $166,6 + 9,4 = 176 \text{ çështje civile}$). Nga statistikat rezulton se në vitin 2014 kam përfunduar 285 çështje, pra rendimenti për këtë vit është $285/176 \times 100 = 161,9\%$. Nga ana tjetër, duke qënë se gjatë vitit 2013 nuk kam qënë duke ushtruar detyrën, rezulton se në janar 2014 nuk kam patur çështje të mbartura, të cilat si rregull përfundohen në muajt e parë të vitit. Në lidhje me situatën e mësipërme, duke qënë se unë si gjyqtare nuk kam patur çështje gjyqësore të mbartura nga viti 2013 dhe jam përfshirë në procedurat e shortit për herë të parë më datë 11.02.2014, kam qënë në pamundësi objektive për të shpallur vendime tre muajt e parë të vitit 2014. Për të provuar këtë fakt, po paraqes në cilësinë e provës edhe statistikat mujore për muajin Janar, Shkurt, Mars të vitit 2014, nga përmbajtja e të cilave rezulton se për muajin janar dhe Shkurt kam 0 vendime gjyqësore të shpallura për muajin Shkurt kam 3 vendime të shpallura dhe për muajin Mars kam vetëm 10 vendime gjyqësore të shpallura (të cilët lidhen me çështje gjyqësore të shortuara në muajin Shkurt-Mars). Nga ana tjetër, nëse i referohemi statistikës mujore të muajit prill 2014, rezulton se unë kam shpallur 19 vendime gjyqësore. Për vitin 2014 dosjet e para në short i kam marrë më datë 11.02.2014, rezulton se vendimet gjyqësore që janë shpallur gjatë muajve Shkurt-Prill 2014, i përkasin çështjeve gjyqësore të gjykuara për një periudhë kohe më të shkurtër se dy muajt, duke u konsideruar ky një tregues që reflekton rendiment të lartë në punë. Në vijim të argumentave të mësipërme, vlerësoj se nëse do të llogaritej edhe për tre muajt e parë të vitit 2014 një sasi mesatare prej 36 vendimesh gjyqësore të shpalluar për çdo muajt, atëherë rendimenti im në punë llogaritet të jetë 100%. Në këto kushte vlerësoj se duke referuar formulën për llogaritjen e rendimentit në punë [tërësia e vendimeve të shpallura brenda një viti kalendarik, pjesuar me tërësinë e dosjeve gjyqësore të caktuara për gjykim brenda vitit kalendarik (pa llogaritje dosjet e mbartura nga viti i mëparshëm)], vlerësoj se nëse unë do të kisha dosje të mbartura nga vitit 2013, do të kisha të gjithë mundësinë objektive për të shpallur vendime edhe tre muajt e parë të vitit 2014. Mungesa e vendimeve të shpallura për këtë periudhë, nuk lidhet me aftësinë time si gjyqtare apo rendimentin tim në punë, por me rrethana objektive të pavarura prej meje dhe për rrjedhojë, rezultati i llogaritjes së rendimentit në punë, në rastin konkret, paraqitet si një rezultat fiktiv negativ (më i ulët se realiteti). Nga ana tjetër, në llogaritjen e rendimentit në punë, përveç faktit se tre muajt e parë të vitit 2014 nuk kam patur mundësi objektive të shpall vendime gjyqësore (për shkaqe që nuk varen nga aftësia ime si gjyqtare), duhet të merren në konsideratë edhe disa elementë të tjerë objektivë dhe konkretisht: **Së pari**, rreth gjysma e ngarkesës sime vjetore është shortuar 4 muajt e fundit të vitit 2014. Konkretisht nga studimi i materialit të caktimit të çështjeve gjyqësore me short, rezulton se për periudhën 01.09.2014-31.12.2014, më janë caktuar me short 188 dosje për gjykim. Duke vlerësuar periudhën e shkurtër kohore (4 muajt e fundit të vitit), gjatë të cilës janë shortuar më shumë se gjysma e ngarkesës, si dhe natyrën e gjykimeve civile, të cilat zgjatin në kohë për shkak të procedurës, vlerësoj se kam qënë në pamundësi objektive për të përfunduar të gjitha këto çështje gjyqësore deri në fund të vitit 2014. **Së dyti**, në muajin Korrik 2014, gjyqtarja Irena Gjoka është larguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë. Për rrjedhojë të gjitha çështjet gjyqësore që kishte për gjykim kjo gjyqtare, janë rishortuar ndërmjet gjyqtarëve të tjerë, nëpërmjet shorteve të realizuara më datë 03.09.2014 dhe 04.09.2014. Në këto kushte, për shkak

të shpërndarjes së çështjeve gjyqësore të gjyqtarës Irena Gjoka, më janë caktuar në mënyrë të menjëhershme për gjykim 18 çështje gjyqësore. Përveç këtij fakti, në fillim të muajit shtator 2014 janë hedhur në short edhe të gjitha dosjet gjyqësore të cilat ishin grumbulluar gjatë muajit gusht 2014, duke u caktuar me short në mënyrë të menjëhershme vetëm në fillim të muajit shtator 22 dosje gjyqësore (data 1-4 Shtator 2014) dhe deri në fund të këtij muaji, më janë caktuar me short gjithsej 67 dosje gjyqësore. Kjo ngarkesë e menjëhershme me çështje gjyqësore në një kohë të shkurtër (brenda një muaji), ka sjellë vështirësi në menaxhimin dhe vënien në lëvizje të të gjitha çështjeve gjyqësore, fakt që duhet të vlerësohet në drejtim të rendimentit në punë. **Së treti**, në llogaritjen e rendimentit në punë duhet të merret në konsideratë edhe ngarkesa me dosje gjyqësore në muajin e fundit të vitit (në muajin dhjetor), dosje të cilat për shkak të kohës të shkurtër deri në fund të vitit, nuk mund të përfundohen me vendim. Referuar dokumentacionit të shpërndarjes së dosjeve me short, rezultojnë se për muajin Dhjetor 2014, më janë caktuar për gjykim gjithsej 44 çështje gjyqësore nga të cilat, 28 çështje gjyqësore janë civile me palë kundërshtare, të cilat për nga vetë natyra e tyre, nuk mund të përfundohen brenda muajit. Në këto kushte, vlerësoj se mbi bazën e parimit të objektivitetit këto çështje (civile themeli) nuk duhet të llogariten në çështjet gjyqësore të cilat objektivisht mund të përfundohen brenda vitit. Në sitezë të analizës së mësipërme, duke vlerësuar faktin se, në periudhën Janar-Mars 2014 kam qënë në pamundësi objektive të shpalljes së vendimeve gjyqësore (për shkak se nuk kam patur dosje gjyqësore të mbartura); faktin se në katër muajt e fundit të vitit, më janë caktuar për gjykim rreth gjysma e ngarkesës vjetore; faktin që në muajin Shtator 2014 më janë caktuar për gjykim rreth 67 dosje gjyqësore, nga të cilat 18 dosje në mënyrë të menjëhershme; faktin që në muajin e fundit të vitit më janë caktuar për gjykim 44 dosje gjyqësore (nga të cilat 28 çështje gjyqësore civile themeli, të cilat objektivisht nuk mund të përfundohen brenda të njëjtit vit), vlerësoj se duhet të rishikohet llogaritja e rendimentit në punë. Në lidhje me sa më sipër, vlerësoj se nëse për tre muajt e parë të vitit do të më llogaritet një mesatare prej 36 vendime të shpalluar në muaj (gjithsej 108), të cilat nuk janë shpallur për shkaqe të pavarura nga gjyqtari (ndërkohë që rezultojnë se vitet vijuese kam shpallur një numër të përafërt vendimesh për tre muajt e parë të vitit), si dhe nëse në llogaritjen e rendimentit në punë do të zbriten edhe dosjet e caktuara me short muajin e fundit të vitit (vetëm 28 dosjet civile me palë kundërshtare), të cilat objektivisht nuk mund të përfundohen brenda vitit, atëherë rendimenti im në punë për vitin 2014 rezultojnë të jetë mbi 100%. **ii. Për vitin 2016.** Në vitin 2016, unë kam qënë në detyrë efektivisht për periudhën 01.01.2016-29.02.2016, pasi për periudhën 01.03.2016-31.12.2016 kam qënë me leje lindje. Në lidhje me sa më sipër, referuar periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, rezultojnë se për vitin 2016, kam ushtruar efektivisht detyrën për një periudhë më pak se dy muaj. Në këto kushte, duke vlerësuar faktin se nuk kam qënë efektivisht në detyrë nga Marsi 2016 e në vazhdim, është e pamundur llogaritja e rendimentit në punë për këtë vit dhe bazuar në parimin e objektivitetit, vlerësoj se rendimenti në punë duhet të llogaritet 100%. Në lidhje me këtë konkluzion, kërkoj të merren në konsideratë të gjitha argumentat e përdorura nga ana ime në analizën e rendimentit për vitin 2014. Nga ana tjetër, në lidhje me vitin 2016, dua të sjell në vëmendjen tuaj se në javën e parë dhe të dytë të muajit Janar si rregull gjykata zhvillon procedurën e mbartjeve të dosjeve gjyqësore dhe nuk zhvillohen procese gjyqësore. Si rrjedhim, në muajt Janar- Shkurt 2016 unë kam punuar efektivisht më pak se 2 muaj të plotë. Sipas të dhënave statistikore, rezultojnë se për këtë periudhë prej rreth një muaji (01.01.2016-28.02.2016), unë kam shpallur 88 vendime gjyqësore. Ky është një tregues i rendimentit së lartë në punë dhe shpejtësisë në gjykimin e çështjeve. Periudhat të cilat unë nuk kam qënë efektivisht në punë apo periudhat në të cilat kam patur pengesa objektive për shpalljen e vendimeve gjyqësore, nuk mund të llogariten negativisht në raport me rendimentin në punë, duke bërë shpërndarje të ngarkesës në të gjithë vitin, kur unë efektivisht e kam menaxhuar atë ngarkesë çështjesh brenda një periudhe më të shkurtër kohore. Në këto kushte, vlerësoj se ngarkesa në punë për efekt të llogaritjes së rendimentit, duhet të vlerësohet në mënyrë proporcionale në raport me periudhën e vitit brenda të cilit kam gjykuar sasinë e caktuar të çështjeve gjyqësore. Në sintezë të të gjitha argumentave të parashtruara më sipër, vlerësoj se rendimenti im në punë për të treja vitet e

vlerësimin duhet të llogaritet mbi 99% dhe për rrjedhojë, në lidhje me këtë kriter duhet të vlerësohem me pikët maksimale.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 84.31%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 4 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”* Bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, rezulton se gjyqtarja nuk ka tejkalar standardin minimal të ngarkesës, prandaj justifikohet një shkallë më e lartë pikëzimi. Në të njëjtin konkluzion arrihet edhe nëse tejkalimi i standardit minimal sasior do të llogaritej për një periudhë 3/vjeçare, pasi referuar të dhënave statistikore ka rezultuar se gjyqtarja ka një mesatare gjykimi prej 144 çështje/vit.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli duke marrë parasysh dhe kundërshtimet e paraqitura nga ana e gjyqtarës, të diskutuara në mbledhjen plenare, u arrit në përfundimin që gjyqtarja Olkeda Lice të vlerësohet me pikëzim maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “ +99%”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, është konstatuar se gjyqtare Olkeda Manellari, ka respektuar afatin ligjor të dorëzimit të vendimit në tre rastet që i përkasin dosjeve 1, 2 dhe 5. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 1 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 5 ditë nga shpallja (shih dosjen 2); për 13 ditë nga shpallja (shih dosjen 3), për 11 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 3 ditë nga shpallja (shih dosjen 5).”

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa **afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor**, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte **parashikuar 10 ditë** (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- a) Dosja 1 (*çështje penale*), që i përket vendimit me nr.530, datë 27.07.2015, është dorëzuar në datën 28.01.2015 - (1 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- b) Dosja 2 (*çështje penale*), që i përket vendimit me nr. 962, datë 18.12.2015 është dorëzuar në datën 23.12.2015 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- c) Dosja 3 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr.654, datë 15.05.2015 është dorëzuar në datën 28.05.2015 - (13 ditë), tej afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- d) Dosja 4 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr. 1348, datë 22.10.2015 është dorëzuar në datën 02.11.2015 - (10 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- e) Dosja 5 (*kërkesë penale*), që i përket vendimit me nr.887, datë 25.08.2014 është dorëzuar në datën 28.08.2014 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 27.02.2023, rezulton se:

- a) Dosja 6 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr.1289, datë 10.11.2014 është dorëzuar në datën 24.11.2014⁶² - (13 ditë), tej afatit 10 ditor, të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- b) Dosja 7 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr.1367, datë 25.11.2014 është dorëzuar në datën 02.11.2014 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- c) Dosja 8 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr.998, datë 09.09.2014 është dorëzuar në datën 15.09.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile’;
- d) Dosja 9 (*çështje penale*), që i përket vendimit me nr.621, datë 10.09.2015 është dorëzuar në datën 15.09.2015 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- e) Dosja 10 (*çështje penale*), që i përket vendimit me nr.952, datë 17.12.2015 është dorëzuar në datën 21.12.2015 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- f) Dosja 11 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr.496, datë 15.04.2015 është dorëzuar në datën 24.04.2015 - (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për çështjet e kategorisë “Penale” është 4 ditë; për kategorinë “Civile themeli” është 10.4 ditë; dhe për kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale” është 3 ditë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” është “Më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);

⁶² Referuar kalendarit, data 24.11.1014 është ditë e hënë.

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari, ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore në tre dosjet penale të shortuara, por edhe në 2 dosjet penale që i përkasin dokumenteve 1 e 3 të përzgjedhur nga vet subjekti i rivlerësimit (me hollësisht shih analizën e dosjeve 1, 2 dhe 5). Të pesë gjykimet penale të vëzhguara nga ana jonë, kanë përfunduar në respektim të afateve standarte të caktuara nga Sistemi i Vlerësimit. Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve", së bashku me Aneksin I "Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore". Ndërkohë, rezultoi se në tre gjykimet civile që ju përkasin dosjeve të shortuara 3 dhe 4, por edhe dokumentit nr. 2 të përzgjedhur nga vet subjekti, performanca në punë e gjyqtarës ka qënë e dobët dhe të tre gjykimet kanë përfunduar në shkelje të afatit standart të gjykimit. Pra, gjyqtarja Manellari nuk ka të njëjtën efikasitet në gjykimet civile, sikurse e ka atë në gjykimet penale.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, pasi dosja me nr. i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1-që i përket çështjes penale, me nr. 810 regjistri, datë regjistrimi 19.06.2015, përfunduar me vendimin nr.583, datë 27.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, të cilat të dyja kanë qënë efektive.
- Dosja 2-që i përket çështjes penale, me nr.1097 regjistri, datë regjistrimi 25.09.2015, përfunduar me vendimin nr.962, datë 18.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) ka qënë seancë joproduktive për shkak të mosparaqitjes së prokurorit.
- Dosja 3-që i përket çështjes civile, me nr.780/550 regjistri, datë regjistrimi 20.03.2014, përfunduar me vendimin nr.654, datë 15.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 18 (tetëmbëdhjetë) seanca nga të cilat 7 (shtatë) seanca janë përgatitore dhe 11 (njëmbëdhjetë) gjyqësore, nga të cilat rezulton se 1 (një) seancë ka qënë seancë joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të të paditurit dhe paditësi ka kërkuar të mos vijonte gjykimi pa praninë e përfaqësuesit të palës kundërshtare. Të gjitha seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimin e palëve me fletëthirrje, me afishim publik; plotësimin e të metave të padisë; depozitimin e provave shkresore; lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim.
- Dosja 4-që i përket çështjes civile, me nr.1457/536 regjistri, datë regjistrimi 31.07.2014, përfunduar me vendimin nr.1348, datë 22.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 18 (tetëmbëdhjetë) seanca, nga të cilat 8 (tetë) seanca përgatitore dhe 10 (dhjetë) gjyqësore, nga të cilat rezulton se 2 (dy) seanca kanë qënë seancë joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të paditësit. Të gjitha seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimin e palëve me fletëthirrje, me afishim publik; plotësimin e të metave të padisë; thirrjen e dëshmitarëve; depozitimin e provave shkresore; lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim; si dhe për shpalljen e vendimit të arsyetuar.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6-që i përket çështjes civile, me nr.1205 regjistri, datë regjistrimi 09.06.2014, përfunduar me vendimin nr.1289, datë 10.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e

çështjes të jetë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) seanca përgatitore dhe 3 (tre) seanca gjyqësore. Vetëm 1 (një) seancë ka rezultuar joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të paditësit. Të gjitha seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: plotësimin e të metave procedurale lidhur me aktin e përfaqësimit, për marrjen e provave.

- Dosja 7-që i përket çështjes civile, me nr.1372 regjistri, datë regjistrimi 10.07.2014, përfunduar me vendimin nr.1367, datë 25.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) seancë përgatitore dhe 4 (katër) seanca gjyqësore. Vetëm 1 (një) është seancë joproduktive për shkak të mosparaqitjes së të paditurit dhe paditësi ka kërkuar që të mos zhvillohet gjykimi në mungesë. Dy seanca janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: për tu paraqitur provat në formën e duhur ligjore.
- Dosja 8-që i përket çështjes civile, me nr.1340 regjistri, datë regjistrimi 08.07.2014, përfunduar me vendimin nr.998, datë 09.09.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) seanca përgatitore dhe 1 (një) seancë gjyqësore. Nuk ka seanca joproduktive. Një seancë është shtyrë për shkaqe procedurale, njoftimin efektiv të të paditurit.
- Dosja 9-që i përket çështjes penale, me nr.688 regjistri, datë regjistrimi 27.05.2015, përfunduar me vendimin nr.621, datë 10.09.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat nuk ka asnjë seancë joproduktive, por në dy seanca ka qenë prokurori shkaktari i shtyrjes së seancës sepse ka kërkuar dy herë kohë për të depozituar bisedimet përfundimtare.
- Dosja 10-që i përket çështjes penale, me nr.1113 regjistri, datë regjistrimi 29.09.2015, përfunduar me vendimin nr.952, datë 17.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat nuk ka asnjë seancë joproduktive, por një seancë është shtyrë për të njoftuar mbrojtësin e caktuar kryesisht, ndërsa seanca tjetër për t'i dhënë kohë prokurorit për të depozituar bisedimet përfundimtare.
- Dosja 11-që i përket çështjes civile, me nr.2137/475 regjistri, datë regjistrimi 23.12.2014, përfunduar me vendimin nr.496, datë 15.04.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca, nga të cilat 1 (një) seancë përgatitore dhe 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm një seancë ka qenë joproduktive, për shkak se Gjyqtarja ka qenë në Analizën vjetore të Gjykatës. Një prej seancave është shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: t'i jepej kohë palës paditëse të për të kërkuar të dhënat dhe dokumentet e nevojshme për gjykimin dhe të mbajë qëndrimin e saj rreth objektit të padisë.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli dhe civile themeli) varion nga 1 deri në 18 seanca gjyqësore (përfshirë seancat përgatitore). Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë **5 (pesë)**⁶³ seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përfshirë seancat përgatitore), **3 (tre)**⁶⁴ seanca gjyqësore në çështje penale themeli.

Në total numri mesatar i seancave është 4.4 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile dhe penale themeli me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale*). Në çështjet penale data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në

⁶³ Nga raporti i totalit të seancave me nr. e çështjeve civile (32/6) rezulton 5.33.

⁶⁴ Nga raporti i totalit të seancave me nr. e çështjeve penale (13/4) rezulton 3.25.

dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimi i mbrojtësit të të pandehurit, marrje e informacionit dhe provave nga të tretët, plotësimi i të metave të padisë dhe akteve të përfaqësimit, lënia kohë palëve për të paraqitur bisedimet përfundimtare, njoftimi i dëshmitarëve, njoftimi efektiv i palëve me fletëthirrje dhe afishim publik. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale, *si rregull*, janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, por edhe në çështjet civile konstatohet se gjyqtarja cakton përgjithësisht seanca të afërta në kohë nga njëra – tjetra jo më shumë se 1 muaj larg.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short,⁶⁵ rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj, pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joprojektive.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joprojektive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “*Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*” gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë.

⁶⁵Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “*Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse*”.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjen 5), me 2 seanca (shih dosjen 1), me 6 seanca (shih dosjen 2) dhe me 18 seanca (shih dosjet 3 e 4) Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 45 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 28 seanca nuk kanë qenë produktive. Vetëm dy seanca që i përkasin dosjes penale me nr. 2 janë jo-produktive, ndërsa 26 seancat e tjera jo-produktive ju përkasin dosjeve civile me nr. 3 dhe 4. Gjykimet civile që ju përkasin dosjeve 2 dhe 3 dhe që kanë shumë seanca joproduktive, janë gjykime të mosmarrëveshjeve civile me palë kundërshtarë. Më hollësisht për shkaqet e shtyrjes së seancave shih analizën e dosjeve 3 dhe 4. Seancat gjyqësore përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por hasen edhe raste kur seancat kanë filluar me vonesë dhe në procesverbalin gjyqësor gjyqtarja është kujdesur të pasqyrojë shkakun e vonesës. Nuk është konstatuar që fillimi i seancës me vonesë të ketë ndikuar në mbarëvajtjen e gjykimet. Në dosjet nr. 1 dhe nr. 2, është konstatuar se seancat gjyqësore janë regjistruar të gjitha në audio. Gjithashtu seanca që i përket dosjes nr. 5, nuk është zhvilluar në audio, për shkak të difekteve në sistemin audio sipas të dhënave të pasqyruara në procesverbalin gjyqësor. Përgjithësisht nga të dhënat e mësipërme, mund të themi që gjyqtare Olkeda Manellari, i ka kushtuar vëmendje zhvillimit të seancave gjyqësore në funksion të solemnitetit dhe transparencës së gjykimet.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 (dhjetë) prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtarë, 1 (një) çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në 5 (pesë) ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimet të çështjeve civile dhe penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, në përgjithësi mbajtur me regjistrim audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Shkak i mos zhvillimit të të gjitha seancave gjyqësore me sistemin audio ka qenë për arsye administrative dhe funksionaliteti në gjykatën pranë se cilës ka ushtruar funksionin Gjyqtarja në periudhën e vlerësimit (për shkak të pamundësisë së zhvillimit të seancës gjyqësore në sallë, mungesa e sallave të gjykimet).

Pavarësisht këtij shkakui, seancat të cilat nuk janë zhvilluar me sistemin audio, janë dokumentuar me procesverbal gjyqësor me shkrim të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 1 deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohet edhe një numër seancash (15 seanca)⁶⁶ të filluara me më shumë se 20 minuta deri në 1 orë e 4 minuta vonesë nga ora e planifikuar. Në tërësi pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej seancave gjyqësore, të cilat rezultojnë në një përqindje të vogël në raport me seancat e analizuara (*16.6% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë*⁶⁷) nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relativit të gjyqtarës lidhet me pritjen e zhvillimit të seancës gjyqësore me sistemin audio duke qenë se sallat e gjykimit kanë qenë të zëna me gjykime të tjera.

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe

⁶⁶ Dosja 2- Seanca e datës 16.12.2015 është çelur me **50 minuta** vonesë;

Dosja 3: Seanca e datës 10.09.2014 është çelur me **20 minuta** vonesë; seanca e datës 02.10.2014 është çelur me **30 minuta** vonesë; seanca e datës 19.01.2015 është çelur me **20 minuta** vonesë; seanca e datës 27.03.2015 është çelur me **44 minuta** vonesë;

Dosja 4: Seanca përgatitore e datës 08.10.2014 është çelur me **1 (një)** orë vonesë; seanca e datës 08.05.2015 është çelur me **20 minuta** vonesë; seanca e datës 09.06.2015 është çelur me **22 minuta** vonesë; seanca e datës 07.09.2014 është çelur me **1 orë e 4 minuta** vonesë; seanca e datës 21.10.2015 është çelur me **35 minuta** vonesë;

Dosja 7: Seanca e datës 10.11.2014 është çelur me **25 minuta** vonesë; seanca e datës 19.11.2014 është çelur me **30 minuta** vonesë;

Dosja 8: - Seanca e datës 09.09.2014 është çelur me **33 minuta** vonesë;

Dosja 9: Seanca e datës 25.06.2015 është çelur me **21 minuta** vonesë;

Dosja 11: Seanca e datës 15.04.2015 është çelur me **31 minuta** vonesë.

⁶⁷ Kjo përqindje i referohet seancave të filluara me = ose < se 20 minuta vonesë, nga planifikimi.

efiçensës së treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Në 15 seancat e filluara me vonesë, referuar relativitetit të gjyqtarës, duket se kanë ndikuar kushtet e punës e infrastruktura e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku në periudhën e vlerësimit kanë ushtruar detyrën 12 gjyqtarë, ndërkohë që ka pasur vetëm 5 salla gjykimi ku proceset regjistrohen në sistemin audio. Gjithashtu duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara, si dhe në orientimin e palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim, ku në dy çështje civile konflikti është zgjidhur me pajtim midis palëve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short për gjyqtaren Olkeda Manellari, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Gjyqtarja pasi merr dosjen për shqyrtim, disponon me vendim për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore sipas rastit. Në dosjet civile, përgjithësisht gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia, fleta e shortit, vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, fletëthirrjet për palët, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, provat, vendimi përfundimtar, ankimi në rast se ka patur, procesverbali dhe vendimi i gjykatës përkatëse të apelit, etj. Gjithashtu në gjykimet që i përkasin dosjeve penale, gjenden: kërkesa për gjykim bashkë me fashikullin hetimor, vendimet për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, fletëthirrjet, provat, procesverbali i seancave gjyqësore, vendimi përfundimtar, ankimi nëse ka dhe vendimi i gjykatës më të lartë, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve procedurale dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur kërkesë padia, aktet e përfaqësimit të palëve, provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, njoftimet e palëve, diskutimet me shkrim të palëve, vendimin e kalimit të çështjes në seancë përgatitore, seancat përgatitore të zhvilluara sipas datave, procesverbali i seancës gjyqësore sipas datave, dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, e shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.*

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short për gjyqtaren Olkeda Manellari, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Gjyqtarja pasi merr dosjen për shqyrtim, disponon me vendim për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore sipas rastit. Në dosjet civile, përgjithësisht gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpatria, fleta e shortit, vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, fletëthirrjet për palët, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, provat, vendimi përfundimtar, ankimi në rast se ka patur, procesverbali dhe vendimi i gjykatës përkatëse të apelit, etj. Gjithashtu në gjykimet që i përkasin dosjeve penale, gjenden: kërkesa për gjykim

bashkë me fashikullin hetimor, vendimet për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, fletëthirrjet, provat, procesverbali i seancave gjyqësore, vendimi përfundimtar, ankimi nëse ka dhe vendimi i gjykatës më të lartë, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet proceduriale.”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seancë përgatitore apo gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve, si dhe vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve si prokura, provat e administruara, diskutimet përfundimtare të palëve, etj). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës”

| Propozim për nivelin e vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES | |
|---|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se znj. Olkeda Manellari, ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, në datën 07.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2011. Fillimin në detyrë

në gjyqësor e ka me Dekretin nr. 7155, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, me Dekretin nr. 8460 datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ku vazhdon dhe aktualisht. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Olkeda Manellari (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLGJ-së). Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.”

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e hartuar të KLGJ-së, konkludohet se: *“Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit "8 tetor 2013- 8 tetor 2016", për gjyqtaren Olkeda Manellari (Lice) janë paraqitur gjithsej 9 ankesa (3 të vitit 2015, 6 të vitit 2016) në Inspektoratin e ish KLD- së. 5 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se 3 prej tyre u arkivuan pasi nuk ka rrethana dhe fakte të vlefshme për shkelje (1 e vitit 2015, 2 të vitit 2016), 2 janë ankesa të përsëritura (ndër të cilat 1 ankesë e vitit 2015 ardhur nga Ministria e Drejtësisë dhe 1 ankesë e vitit 2016); 1 ankesë e vitit 2015, e cila është informacion i kryetarit të gjykatës, verifikuar për mos respektim i disiplinës në punë është vendosur arkivimi pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtarës. 3 ankesa janë verifikuar dhe rezultati është si më poshtë: - 1 ankesë (1 e vitit 2016) verifikuar për zvarritje gjykimi dhe është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional. 2 ankesa, ndër të cilat 1 ankesë e vitit 2016 (verifikuar për zvarritje gjykimi e papërfunduar) me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kjo praktikë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni, me shkresën përcjellëse nr. 862/4 prot., datë 06.07.2020, shoqëruar me procesverbalin nr. 862/5 prot., datë 28.07.2020Ndërsa 1 ankesë e viti 2016 (e njëjta ankesë ardhur nga presidenca) është propozuar bashkimi me ankesën e dorëzuar tek Inspektorit i Lartë i Drejtësisë. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Olkeda Manellari (Lice) përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.”*

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLGJ nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 602, datë 19.12.2022, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarës, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pabazuara.

Për periudhën e vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cenimit të etikës, pasi ato referohen vetëm si pretendime që zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, të cilat nuk përbëjnë burim më vete vlerësimi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Olkeda LICE dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjatë periudhës 08.10.2013-08.10.2016 në adresë të gjyqtarës Olkeda MANELLARI në ish Inspektoratin e KLD-së nuk është depozituar asnjë ankesë në lidhje me integritetin e saj”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren Olkeda LICE, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore që kanë lidhje me nderin dhe dinjitetin në ushtrimin e funksionit. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “08 tetor 2013-08 tetor 2016”, për gjyqtaren Olkeda LICE janë paraqitur 9 ankesa (3 në vitin 2015 dhe 6 ankesa në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. 5 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se 3 prej tyre u arkivuan pasi nuk ka rrethana dhe fakte të vlefshme për shkelje (1 e vitit 2015, 2 të vitit 2016) 2 janë ankesa të përsëritura (ndër të cilat 1 ankesë e vitit 2015 ardhur nga Ministria e Drejtësisë dhe 1 ankesë e vitit 2016). 1 ankesë e vitit 2015, e cila është informacion i kryetarit të gjykatës, verifikuar për mosrespektim i disiplinës në

punë është vendosur arkivimi pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtares. 3 ankesa janë verifikuar dhe rezultati është si më poshtë: 1 ankesë (1 e vitit 2016) verifikuar për zvarritje gjykimi dhe evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional. 2 ankesa, ndër të cilat 1 ankesë e vitit 2016 (verifikuar për zvarritje gjykimi e arkivuar me Vendim të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Nr. 384/1 Prot., datë 14.02.2023. Ndërsa 1 ankesë e vitit 2016 (e njëjta ankesë ardhur nga presidenca) është propozuar bashkimi me ankesën e dorëzuar tek Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Olkeda MANELLARI (LICE) përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore. Për gjyqtaren Olkeda LICE përgjatë periudhës së rivlerësimit rezulton që ndaj saj të ketë ardhur një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë për procedim disiplinor (kërkesa mban nr.4853/7 prot., datë 01.02.2015, regjistruar në ish KLD me nr.3778 prot., datë 01.02.2015) për “Shkarkim nga detyra” është trajtuar në mbledhjen e ish Këshillit të datës 24.01.2018, ku dhe është rrëzuar. Nuk është propozuar masë tjetër disiplinore.

Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: *“Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti në pyetësorët e dërguar, si dhe provat dhe parashtrimet në përgjigje të barrës së provës, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon: i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë, ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij. iii. Ekzistenca e një balance të vogël në analizën financiare nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cënuar besimin e publikut te drejtësia. iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës "a" të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.”⁶⁸*

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 602, datë 19.12.2022, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtares, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: *“Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk rezultuan të dhëna të tjera që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Olkeda LICE ka arritur një nivel të*

⁶⁸ Po aty, faqet 20-21.

*besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të gërmës “b” të nenit 59/1 të Ligjit nr. 84/2016.”*⁶⁹

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Olkeda Manellari. Dy pretendime për konflikt interesi të gjyqtarës Olkeda Manelari, të paraqitura si ankesë në ish – inspektoratin e KLD-së, pas verifikimit të tyre rezultuan të pabazuara. Për vetë gjyqtaren Manellari, në asnjë nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk ka patur kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese, apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari, nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standartin e gjykatës së paanshme”.*

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

⁶⁹ Po aty, faqet 23 – 24.

Referuar akteve burim vlerësimi, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Për gjyqtaren *Olkeda LICE* në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve”.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet

të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

| Propozim për nivelin e vlerësimit ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE | |
|---|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor, por edhe në diskun që pasqyron regjistrimin e seancave në audio është konstatuar se gjyqtare Olkeda Manellari, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.”

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtares Olkeda Manellari, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nga analiza e pesë dosjeve të shortuara, nuk hasen problematika në bashkëpunimin e subjektit të rivlerësimit me stafin administrativ të gjykatës.”

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të

të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është çertifikuar në 11 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhënat tek Trajnimet në 3 Vitet e Fundit). Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 22 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë.*”

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1729/5 Prot., datë 17.06.2021, vërtetimit me nr. 768 Prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.768 Prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, Gjyqtarja Olkeda Lice është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 11 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 21 ditë trajnimi.

Rezulton gjithashtu se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnime jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, i cili rezulton të jetë aktivitet i formimit profesional. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në: Kursin trajnues të anglishtes ligjore për gjyqtarë, i zhvilluar nga muaji shkurt 2013 deri në muajin korrik 2014, organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Ambasada Amerikane në Tiranë Shqipëri, si dhe në trajnimin jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës - trajnimi i organizuar nga Këshilli i Europës në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, me temë “Konventa Europiane e të Drejtave të

Njeritu dhe praktikat gjyqësore lidhur me fyerjen dhe shpifjen”, zhvilluar në datat 3-4 korrik, 2014.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile, penale, procedurale, ndërkombëtare dhe familjare, gjithsej 12 aktivitete të zhvilluara për 21 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarës në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarës, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren Olkeda LICE ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Ne lidhje me këtë tregues gjyqtarja Olkeda Lice ka paraqitur kundërshtimet duke parashtruar se: *Bazuar në vendimin Nr. 264, datë 21.11.2019 “Për miratimin e metodologjisë së pikëzimit me qëllim vlerësimin e nivelit të pikëzimit të gjyqtarit”, me këtë tregues vlerësohet gatishmëria dhe shfaqja e vullnetit të gjyqtarit pranë organeve përkatëse me qëllim përfshirjen në listat e gjyqtarëve udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, dhe/ose si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në*

trajtime të organizuara nga institucione të tjera. Në lidhje me sa më sipër, ju bëj me dije se për periudhën e vlerësimit 2013-2016, kam treguar gatishmëri në lidhje me pjesëmarrjen aktive në trajtime të tjera, të organizuara në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës. Konkretisht, në vitin 2013-2014 jam angazhuar në projektin e të organizuar nga Ambasada Amerikane në Shqipëri në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin e gjyqtarve lidhur me anglishten ligjore dhe jo vetëm. Në këtë projekt, kam qënë në 1) rolin e lehtësueses efektive (pavarësisht se si pozicion për Shkollën e Magjistraturës është ligjërues vite më vonë) si dhe 2) jam ofruar për të udhëhequr me asistencë legjislative të vendit tonë një student amerikane në Shqipëri: Së pari, ky ka qënë një projekt dinamik, gjatë të cilit jo vetëm jemi trajnuar për anglishten ligjore por edhe jam aktivizuar në pozicionin e lehtësueses për organizatorët e projektit në kuadër të zhvillimit të takimeve të ndryshme profesionale. Për rrjedhim vlerësoj se nuk duhet të trajtohet vetëm në një nga kriteret e vlerësimit (vetëm tek seksioni 4.C.A).

*Gjatë këtij projekti kemi zhvilluar takime me faktorë ndërkombëtarë ndikues në reformën në drejtësi e një prej tyre ka qënë edhe takimi me zj. Kethleen Imholz. Një ndër këto takime ka qënë me qëllim organizimin e gjyqtarve për të diskutuar problematikat e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, ku sikundër rezulton nga e-mail datë 21.Korrik 2014 unë kam patur rolin e lehtësueses për të koordinuar gjyqtarët lidhur me projektin. Ky aktivitet trajnues është pasqyruar edhe në formularin e vetëvlerësimit profesional të plotësuar nga ana ime, për efekt të procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, për të provuar aktivizimin tim në këtë drejtim, po ju paraqes në cilësinë e provës, komunikimin me e mail me organizatoren e projektit dhe që drejtonte takimet dhe trajnimet zj. Daniell Capretti (pedagoge e anglishtes ligjore rezidente në Shqipëri). Sa sipër, ka qënë një përgjegjësi që unë e kam bërë me pasionin e profesionit dhe duke mos patur informacion se kjo do të ishte një ndër kriteret që do të pikëzonte vlerësimin e punës time, nuk i kam kushtuar rëndësi dokumentimit formal të rolit që kam ushtruar në këtë aktivitet. **Së dyti,** Aktiviteti trajnues zhvillohej në praktikë nga zj. Danielle Capretti e cila organizonte axhendën e trajnimit, takimet e ndryshme, shkëmbimin e eksperiencave në fushën e së dejtës. Gjatë këtij programi më është kërkuar nga Zj. Capretti nëpërmjet e-mail, që të asistoj me ndihmë juridike një studente amerikane me Bursë të Plotë të Departamentit të Shtetit Amerikan, e cila zhvillonte projekte studimore në Shqipëri në fushën e drejtësisë. Në këtë rast unë kam shprehur gatishmërinë time për të ofruar asistencën e nevojshme studenten amerikane në Shqipëri. Lidhur me shprehjen e gatishmërisë time po ju paraqes bashkëlidhur kopje të e-mail datë 14 Janar 2014”. Në lidhje me sa më sipër, duke vlerësuar se gjatë periudhës së vlerësimit kam shprehur gatishmëri për të qënë aktive në koordinimin e gjyqtarve me organizatorët e projektit si dhe kam qënë e gatshme të udhëheq student amerikanë si pjesë e projektit të Ambasadës Amerikane në Shqipëri, i cili ka qënë një ndër partnerët kryesorë të Reforëms në Drejtësi vlerësoj se në lidhje me këtë kriter duhet të më shohen edhe dy pikë të tjera, duke u vlerësuar me 5 pikë”.*

Pasi dëgjoi relatorin e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarës, Këshilli vlerësoi se nuk ishte rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga relatorja. Gjyqtarja, Olkeda Lice, megjithë kundërshtimet në lidhje me këtë tregues, nuk mund të pikëzohet maksimalisht, pasi kurset profesionale lidhur me anglishten ligjore dhe aktivitetet që kane të bëjnë me përmirësimin e gjuhës se huaj nuk mund të kategorizohet në veprimtari nderinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Metodologjia e shpreh qartë cilësinë e lehtësuesit apo të ekspertit, dhe pikëzimi lidhur me këtë tregues ka të bëjë me gatishmërinë e gjyqtarës për të kontribuar si **gjyqtare udhëheqës** në praktikën profesionale të **kandidatëve për**

*gjqtarë, dhe/ose si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera dhe ky nuk është rasti i gjyqtarës subjekt vlerësimi. Së pari, në periudhën për të cilin bëhet fjalë gjyqtarja nuk ka qënë e emëruar për të ushtruar funksionin e saj si gjyqtare në sistemin gjyqësorë, prandaj nuk mund të ishte në cilësinë e gjyqtarës udhëheqëse, kriter i përcaktuar në metodologji për pikëzim për të qënë udhëheqes në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë. Se dyti, nga provat e paraqitura bashkalidhur kundërshtimeve dhe shpjegimeve të gjyqtarës në mbledhje plenare nuk provohet kontributi efektiv i gjyqtarës në rolin ekspertes/lehtësueses, pasi është kufizuar vetëm në “kontribut” sa i përket organizimit të trajnimit në lidhje me axhenden, organizimin dhe koordinimin e orareve të aktivitetit. Se treti, Metodologjia parashikon pikëzimin e këtij treguesi në vlerë maksimale, kur gjyqtarja subjekt vlerësimi provon faktin se roli dhe gatishmëria e saj në cilësinë e lehtësuesit apo të ekspertit, shtrihet mbi kontributin si gjyqtare udhëheqëse në praktikën profesionale të **kandidatëve për gjyqtarë** dhe/ose si ekspert/lehtësues në **trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës**, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera dhe jo mbi student amerikanë si pjesë e projektit të Ambasadës Amerikane në Shqipëri, që zhvillon thjesht projekte studimore në Shqipëri në fushën e drejtësisë.*

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

***Disponueshmëria e gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësoj se në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARËS NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarës, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013 -2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si:

pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit, etj.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren Olkeda LICE ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Edhe për këtë tregues gjyqtarja Olkeda Lice, ka paraqitur kundërshtimet e saj duke parashtuar se: *Bazuar në vendimin Nr. 264, datë 21.11.2019 "Për miratimin e metodologjisë së pikëzimit me qëllim vlerësimin e nivelit të pikëzimit të gjyqtarit", rezulton se në gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin e drejtësisë në mënyra të ndryshme. Sipas këtij akti, këto aktivitete përfshijnë veprimtari jashtë funksionit me ose pa pagesë të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike. Në lidhje me sa më sipër, ju bëj me dije se për periudhën kohore Shkurt 2013-Korrik 2014 kam marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Ambasada Amerikane në Shqipëri ku trajnimi ishte interaktiv. Ky projekt është pasqyruar edhe në Formularin e vetvlerësimit profesional të gjyqtarit të plotësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit. Trajnimi ishte zhvilluar në formën e bashkëbisedimit interaktiv dhe shkëmbimin e mendimeve teorike dhe praktike lidhur me ligjet dhe sistemin në drejtësi dhe evidentimin e diferencave mes sistemeve të ndryshme (duke mbajtur në konsideratë faktin se ka qënë fillimi i reformës së Drejtësisë). Në kuadër të këtij projekti të organizuar nga Ambasada Amerikane në Shqipëri kemi zhvilluar edhe një takim në ambientet e Ambasadës Amerikane ku kemi shkëmbyer eksperiencën dhe mendime mbi ligjet dhe sistemin. Lidhur me këtë veprimtari po ju paraqes e-mail të datës 26 Nëntor 2013 dhe 3 Dhjetor 2013. Gjithashtu kemi zhvilluar edhe takime të tjera me si me Drejtorin e Anglishtes Rajonale përfaqësues I Ambasadës Amerikane z. George Chinnery ku kanë marrë pjesë edhe profesionistë të tjerë të ligjit ku kemi diskutuar problemet e reformës në drejtësi si dhe çështje të ndryshme juridike. (dokumentuar me e-mail datë 14 Tetor 2013). Në lidhje me provat për bashkëpunimin me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike, po ju paraqes korrespondencën e mbajtur me zj.Danielle Capretti, duke evidentuar faktin se në periudhën ku unë jam angazhuar në këtë veprimtari jashtë funksionit ka qënë e pamundur dokumentimi në formë të tjera të këtyre llojeve të aktiviteteve. Në lidhje me sa më sipër, duke vlerësuar se gjatë periudhës së vlerësimit, jam angazhuar në veprimtari jashtë funksionit që ndikojnë në përmirësimin e sistemit të drejtësisë (sikurse vlerësohet edhe marrëdhëniet me faktorët ndërkombëtarë për perceptimin drejt të situatës në sistem), vlerësoj se në lidhje me këtë kriter duhet të më shohet edhe dy pikë të tjera, duke u vlerësuar me 5 pikë".*

Si dëgjoi relatorin e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarës, Këshilli vlerësoi se nuk është rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga ana e relatores, pasi duhej të provohej kontributi efektiv i gjyqtarës në këto veprimtari përveç se pjesëmarrjes.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarës, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se për gjyqtaren Olkeda LICE ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

| Niveli i vlerësimit AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL | |
|---|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 91 |

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

| Niveli i vlerësimit për çdo kriter | | |
|---|-------|---------------------|
| Kriteri | Pikët | Niveli i vlerësimit |
| 1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit | 100 | Shkëlqyeshëm |
| 2. Aftësitë organizative të gjyqtarit | 100 | Shkëlqyeshëm |
| 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale | 100 | Shkëlqyeshëm |
| 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional | 91 | Shkëlqyeshëm |
| Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit | | |
| Vlerësimi i përgjithshëm | 391 | Shkëlqyeshëm |

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR